



# Annual Report

2024

PËRMBAJTJA

|     |                                       |    |
|-----|---------------------------------------|----|
| 01. | MESAZH NGA DREJTUESIT E BANKËS        | 05 |
| 02. | QEVERISJA KORPORATIVE                 | 11 |
| 03. | STRUKTURA ORGANIZATIVE                | 15 |
| 04. | NJËSIA E KORPORATËS                   | 19 |
| 05. | NJËSIA BANKARE RETAIL                 | 23 |
| 06. | NJËSIA E OPERACIONEVE                 | 27 |
| 07. | BURIMET NJERËZORE                     | 33 |
| 08. | PËRGJEGJSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024 | 39 |
| 09. | RRJETI I DEGËVE                       | 53 |
| 10. | PASQYRAT FINANCIARE                   | 57 |



01

## MESAZH NGA DREJTUESIT E BANKËS

# MESAZH NGA DREJTUESIT E BANKËS

## Të nderuar klientë, punonjës dhe partnerë të ABI Bank,

Viti 2024 shënoi një etapë të rëndësishme në rrugëtimin tonë, duke vijuar me rritjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të aktivitetit dhe arritjen, për të disatin vit rradhazi, të një tjetër niveli rekord në totalin e aktiveve dhe fitimit neto të realizuar nga Banka. Ishte një vit që tregoi edhe njëherë se institucioni ynë ka profesionalizmin dhe thellësinë e qëndrueshmërinë e duhur në marrëdhëniët me klientët, veçori këto që na lejojnë të jemi përpara në një treg gjithmonë e më konkurrues.

Përballë sfidave të tregut financiar dhe sidomos nivelit të lartë inflacionar, ne arritëm të forcojmë pozicionin tonë si bankë korporative me rrënjë tashmë të forta në vend dhe të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve duke shtuar ndjeshëm rrjetin e degëve si dhe duke futur disa risi teknologjike për diversifikimin e kanaleve të pagesave, me synimin e përhershëm për ti dhënë vlerë të shtuar klientëve tanë.

Konkretisht, rritja prej pothuajse 14% e totalit të aktiveve gjatë 2024 u mbështet thujasë tërësisht tek rritja e depozitave të klientëve. Kjo arritje reflekton edhe një element të rëndësishëm cilësor, atë të optimizimit të vazhdueshëm të sinergjive dhe kontributit të përbashkët të njësive të Retail me rritjen e numrit dhe volumeve operacionale të klientëve individë dhe biznese të vogla dhe Korporatës me klientët e biznesit të mesëm dhe të madh si dhe me klientët institucionalë shtetërorë e ndërkombëtarë.

Jemi krenare të theksojmë se gjatë vitit 2024 balanca totale e depozitave kaloi nivelin prej EUR1 miliardë për herë të parë në historinë e ABI Bank. Kjo ecuri lidhet ngushtë jo vetëm me punën e mrekullueshme të stafit tonë por edhe me zgjerimin e rrjetit të degëve të Bankës. Gjatë vitit 2024 Banka hapi 6 degë të reja, 4 nga të cilat në Tiranë, 1 në Durrës e 1 në Vlorë, duke rritur me pothuajse 30% rrjetin e degëve dhe duke zmadhuar në këtë mënyrë edhe bazën e klientelës. Si rezultat, pjesa e tregut që banka përfaqëson për depozitat për individë u rrit nga 5.8% në fund të vitit 2023 në 6.18% në fund të vitit 2024.

Ndërkohë që zgjerimi i rrjetit po vijon edhe gjatë vitit 2025, kontributi i degëve të reja në rritjen e depozitave ka tejkaluar pritshmëritë duke konsoliduar më tej perspektivën e një rritjeje të vazhdueshme dhe solide të Bankës edhe gjatë viteve në vijim.

Aktiviteti i Njësise Bankare Korporative gjatë vitit 2024 shënoi një rritje rekord, duke u bërë promotori kryesor i zgjerimit të portofolit të kredisë së Bankës. Kjo rritje sasiore solli edhe rritjen e pjesës së tregut që ABI Bank përfaqëson në kreditimin e bizneseve, duke forcuar praninë tonë në sektorë prioritarë si turizmi, infrastruktura, energjetika, dhe ndërtimi si dhe duke arritur në mbështetjen e më shumë se 500 kompanive aktive. Rezultati ishte mbrësëlënës edhe për faktin se kredia totale e Bankës u rrit në nivelin e rreth 34% gjatë vitit 2024, krahasuar me një mesatare rritjeje vjetore prej rreth 15% të regjistruar gjatë tre viteve të fundit. Ky zgjerim kontribuoi drejtpërdrejtë në përmirësimin e fitimshmërisë së Bankës, pavarësisht ndikimit të një mjedisi me norma interesi që vijuan tendencën rënëse gjatë vitit.

Rritja e portofolit të kredive duhet vlerësuar jo vetëm për pjesën sasiore por edhe sidomos për cilësinë e kredisë që është në fakt një tipar domethenës i tërë portofolit të kredive të ABI Bank. Specifikisht, në fund të vitit 2024, treguesi i kredive me probleme (NPL) ishte në nivelin e 1.4% për totalin e portofolit dhe në 1.0% për kreditë e biznesit, duke arritur një rezultat unik në treg dhe duke reflektuar një qasje prudente dhe efikase në menaxhimin e riskut. Ky rezultat dëshmon jo vetëm cilësinë e proceseve tona të analizës dhe monitorimit, por edhe partneritetin që kemi arritur të ndërtojmë me klientët, elementë që na lejojnë të adresojmë sfidat e tyre në kohë dhe në bashkërendim. Këto tregues e vendosin ABI Bank si institucionin bankar me cilësinë më të lartë të aktiveve në tregun bankar shqiptar, duke forcuar në këtë mënyrë besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e bankës në periudhën afatgjatë.

Ulja e normave të interesit gjatë vitit 2024 si dhe rritja e pjesëmarrjes së agjentëve ndërkombëtare në ankandet për borxhin e qeverisë Shqiptare nuk krijoi kushte të favorshme për rritjen e portofolit të investimeve në letra me vlerë lokale. Fokusi u mbajt në investime në letrat me vlerë ndërkombëtare dhe në optimizimin e portofolit ekzistues, duke ruajtur volume investimi në nivele të krahasueshme me vitin 2023, ndërkohë që u sigurua një rritje e normës së kthimit nga ky portofol. Gjithashtu, aktiviteti i këmbimeve valutore pësoi rritje krahasuar me një vit më parë, duke dyfishuar volumet dhe fitimin gjatë vitit 2024, rezultat i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit të suksesshëm të njësisë së Thesarit me njësinë Korporatë.

Fitimi neto për vitin 2024 tejkaloi për herë të parë nivelin e EUR30 milionë, duke e renditur ABI Bank ndër katër bankat me fitimshmërinë më të lartë në vlerë absolute në sistem. Ky rezultat i jashtëzakonshëm siguroi gjithashtu ruajtjen e pozicionimit të Bankës si lider i sektorit për sa i takon normës së kthimit nga kapitali (ROE) dhe normës së kthimit nga totali i aktiveve (ROA), duke reflektuar efikasitetin e lartë operacional dhe cilësinë e menaxhimit financiar.

Nga aspekti operacional gjatë vitit 2024, ABI Bank vijoi investimet në kanalet alternative me synimin për të rritur cilësinë e shërbimit dhe për të përmirësuar përvojën e klientëve. Finalizimi i projektit për përfshirjen e skemës MasterCard bëri që ATM-të e

Bankës të jenë të përputhshme me dy skemat më të mëdha ndërkombëtare të pagesave, ndërkohë që u fut për herë të parë produkti i POS, me teknologjinë më të avancuar, duke u mundësuar klientëve tanë pranimin e pagesave me Visa dhe MasterCard. Partneriteti me një nga kompanitë kryesore globale të procesimit të pagesave, solli të ardhura shtesë dhe akses më të gjerë në rrjetin e ATM-ve, ndërsa modernizimi i platformës online mundësoi pagesa në kohë reale dhe pagesa utilitare, duke forcuar njëkohësisht edhe sigurinë transaksionale. Gjithashtu, në përputhje me rregullorët e Bankës së Shqipërisë u implementua autentikimi i sigurt për shërbimet online dhe për pagesat pa kontakt, duke garantuar standarde më të larta sigurie dhe transparence.

Gjatë vitit 2024, ABI Bank vijoi të tregojë angazhimin ndaj përgjegjësisë korporative dhe sociale (CSR), duke mbështetur rreth 40 iniciativa dhe aktivitete humanitare, sociale, kulturore dhe edukative. Nga fushatat e dhurimit të gjakut në ndihmë të femijëve talasemikë, mbështetja për shoqatat e grupeve vulnerabël dhe projektet në mbrojtje të grave e fëmijëve, te programet edukative për brezat e rinj dhe nismat për promovimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, Banka ka treguar kujdes të vazhdueshëm ndaj komunitetit. Në të njëjtën kohë, ABI Bank ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e artit dhe kulturës, duke mbështetur koncerte, festivale, ekspozita dhe aktivitete të tjera të rëndësishme, si dhe ka kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit. Ky angazhim i gjerë, që përfshin bashkëpunime me fondacione, organizata joqeveritare dhe institucione publike, është në thelb të besimit tonë se rritja e Bankës ecën krah për krah me zhvillimin shoqëror dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin ku ne punojmë e jetojmë.

Së fundmi, dhe jo nga rëndësia, vlen të ndalemi në një transaksion blerje korporative që ndikoi një pjesë të mirë të vitit 2024. ABI Bank vitin e kaluar ndërmori një hap strategjik që shënoi një etapë të re në historinë e saj të rritjes, duke finalizuar me sukses blerjen e NOA-s, institucionit të dytë më të madh të mikrokredisë në vend, në Dhjetor 2024. Ky transaksion i jep Bankës një avantazh unik konkurrues, duke e shndërruar në të vetmin institucion financiar në Shqipëri që mbulon të gjithë gamën e financimit. Përmes këtij zgjerimi, ABI jo vetëm që forcon pozicionin si një aktor lider

në sistemin bankar, por krijon mundësi të reja për të mbështetur klientët përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre, duke u bere një partner afatgjatë për sipërmarrjen shqiptare. Për më tepër, prezenca e NOA në Kosovë i krijon Bankës një portë hyrëse në një treg me potencial domethënës zhvillimor. Gjatë vitit 2025, ABI Bank synon të integrojë plotësisht kapacitetet më të mira të NOA-s me eksperiencën dhe fuqinë financiare të Bankës. Vizioni ynë është i qartë: të krijojmë një institucion modern, i aftë të mbështesë çdo individ dhe biznes në Shqipëri dhe më gjerë, nga idetë e para deri tek realizimi i projekteve madhore.

Viti i kaluar dëshmoi fuqinë dhe qëndrueshmërinë e Bankës për të ecur përpara në një mjedis sfidues duke arritur rezultate të larta financiare dhe duke zgjeruar gamën e shërbimeve. Finalizimi me sukses i blerjes së NOA-s, shënoi gjithashtu një hap të rëndësishëm strategjik. Duke hyrë në vitin 2025 dhe më tej, ne mbetemi të vendosur të ndërtojmë dhe zgjerohem edhe më shumë mbi këto arritje, për të konsoliduar vizionin tonë për ABI Bank si një bankë gjithëpërfshirëse dhe inovative, që jo vetëm mbështet klientët dhe partnerët por edhe kontribuon në zhvillimin ekonomik e social të vendit.

Falenderojmë me mirënjohje të thellë klientët, punonjësit dhe partnerët tanë, të cilët me besimin, përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre bëjnë të mundur çdo arritje të ABI Bank.

**Andi Ballta**  
**Brunilda Papa (Jakovi)**  
**Igli Sulaj**



Andi Ballta



Brunilda Papa (Jakovi)



Igli Sulaj



p2

QEVERISJA  
KORPORATIVE

## KËSHILLI DREJTUES

**Kathryn Swintek**

Anëtare e Pavarur

Kryetare e Këshillit Drejtues

**Edmond Çoku**

Anëtar i Pavarur

**Brunilda Papa (JAKOVI)**

Drejtoresh e Njesisë Retail

**Rezzo Ernst Schlauch**

Anëtar i Pavarur

Zëvendës Kryetar i Këshillit Drejtues

**Andi Ballta**

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Banka Amerikane e Investimeve SHA, është shoqëri aksionare me Aksionar të vetëm, e licensuar rregullisht për të zhvilluar veprimtarinë bankare në përputhje me Statutin e Bankës dhe legjislacionin në fuqi.

Banka, e cila cilësohet si një bankë butik, organizohet dhe menaxhohet në bazë të legjislacionit bankar shqiptar, praktikave më të mira bankare ndërkombëtare, si dhe në bazë të politikave, procedurave e rregulloreve të brendshme të saj, të hartuara e miratuara në përputhje me parimet dhe mekanizmat e kontrollit, dhe të gjitha këto janë kolonat mbi të cilat është ndërtuar një strukturë efikase dhe eficiente, transparente për investitorët, që njeh dhe respekton të drejtat e klientëve të saj, kërkesat themelore e thelbësore të legjislacionit shqiptar, si dhe duke siguruar interesat legjitime të Aksionarit të Bankës.

Parimet bazë të Qeverisjes Korporative janë si vijon:

**1.1. Të drejtat e Aksionarit**

Banka ka vendosur rregulla që garantojnë për Aksionarin, marrjen e informacionit të plotë mbi kushtet financiare të Bankës, si dhe mbi vendimet e Manaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në veprimtarinë e saj. Aksionari i vetëm është një organ vendimmarrës i cili ushtron autoritetin e tij në përputhje me Statutin e Bankës, Kodin e Qeverisjes Korporative dhe dispozitat ligjore në fuqi.

**1.2. Përbërja e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë (të pavarur), në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat në Shqipëri. Diversiteti në arsim, përvojë dhe në fushat e ekspertizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues është një faktor kyç në drejtimin e një banke butik.

**1.3. Detyrat e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues, është një organ vendimmarrës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Aksionarit të vetëm. Këshilli Drejtues në përputhje me Statutin e Bankës dhe Kodin e Qeverisjes Korporative përcakton vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës. Qëllimi kryesor i Këshillit Drejtues është të sigurojë veprimtari të shëndetshme të kompanisë, duke ndjekur rritjen afatgjatë të vlerës ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe kontrolluar ekzekutivin në përputhje me interesat e Aksionarit.

**1.4. Kontrolli i Brendshëm**


Banka ka pjese të strutures se saj një divizion të Kontrollit të Brendshëm, i mbikëqyrur nga Komiteti i Kontrollit të Bankës. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat ligjore, përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, ekspertiza dhe monitorimi i të cilëve është një ndihmë e vlefshme dhe e vazhdueshme për Bankën. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues.

# P3

## STRUKTURA ORGANIZATIVE



ABI Core





# P4

## NJËSIA E KORPORATËS

## NJËSIA E KORPORATËS

Viti 2024 shënoi një tjetër hap përpara për ABI Bank, duke konsoliduar më tej pozicionin e saj si një aktor kyç dhe partner strategjik në tregun financiar shqiptar. Në një mjedis ekonomik me ritme të ndryshueshme, banka qëndroi e fokusuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe shërbim cilësor ndaj klientëve të saj.

ABI Bank prej gati 1 dekadë ruan identitetin e saj si një bankë butik, e përqendruar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata dhe në ofrimin e zgjidhjeve të personalizuar financiare. Kjo qasje e ka bërë bankën një pikë referimi për klientët që kërkojnë partneritet të qëndrueshëm dhe fleksibël.

Strategjia e bankës u orientua drejt konsolidimit të rolit si një partner afatgjatë dhe i besueshëm për sektorët strategjikë të ekonomisë, si dhe në rritjen e qëndrueshmërisë institucionale përmes qasjes prudente në administrimin e riskut.

Gjatë vitit, u intensifikua angazhimi për të mbështetur zhvillimin e projekteve me impakt në sektorin real, përfshirë turizmin, energjinë, prodhimin dhe infrastrukturën. Përmes një kombinimi të kujdesshëm të ekspertizës lokale dhe vizionit afatgjatë, ABI vijoi të rrisë portofolin e saj të klientëve dhe të forcojë besimin që tregu ka ndaj saj.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme ka qenë dixhitalizimi i shërbimeve bankare, që ka sjellë përmirësime të dukshme në përvojën e klientëve, duke ofruar shërbime më të thjeshta, më të sigurta dhe më të aksesueshme.

Duke hyrë në një fazë të re zhvillimi, me një bazë kapitali të fortë dhe një ekip të përkushtuar, ABI Bank mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen ndaj ekonomisë shqiptare dhe për të qenë një motor rritjeje në vitet që vijnë, duke treguar rezultate të qëndrueshme dhe potencial të qartë për zgjerim të mëtejshëm në tregun financiar shqiptar.

### Gjatë vitit 2024, strategjia jonë u përqendrua në:

- Zgjerimin e mëtejshëm të portofolit të kredisë, duke arritur një total prej rreth 610 milionë euro, që përfaqëson një rritje prej 34% në krahasim me vitin 2023;
- Rritjen e pjesës së tregut në kreditimin e bizneseve në rreth 10%, duke forcuar praninë tonë në sektorë prioritarë si turizmi, energjetika, infrastruktura dhe ndërtimi;
- Mbështetjen e më shumë se 500 kompanive aktive, me një portofol të diversifikuar dhe të mirëadministruar.

Ne e mbyllëm vitin 2024 me një total kreditimi në shumën rreth Euro 610 milion në nivel Banke duke u rritur në rreth 34% krahasuar me vitin 2023, si një nga bankat me rritjen më të lartë, dhe duke vijuar të mbetemi një institucion i qëndrueshëm dhe i angazhuar për t'i shërbyer klientëve tanë dhe për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Ne disbursuam kredi të reja në vlerë prej rreth Euro 280 milion ndaj klientëve të biznesit, me fokus në financimin e hoteleve apo projekteve të ndërtimit, infrastrukturës energjitike e të tjera.

Fokusi ynë mbeten mbështetja në sektorë të turizmit, të energjitikës, tregtisë me pakicë dhe retail, tregtisë me shumicë, të ndërtimit, e të tjerë sektorë të rëndësishëm strategjikë në Shqipëri, që po përjetojnë rritje dhe zgjerim të rëndësishëm. Përmirësimi në nivelin e kapitalit të bankës dha mundësinë që ABI të mbështesë projekte akoma edhe më madhore dhe me impakt të lartë në ekonominë e vendit.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, klientët e biznesit, kanë rritur ndjeshëm edhe nivelet e likuiditeteve në llogari rrjedhëse apo depozita si dhe aktivitetin e tyre operacional, duke treguar besimin e lartë ndaj bankës, si një partner i rëndësishëm në shërbime financiare, dhe duke dëshmuar se tashmë mbështetja e ABI Bank për biznesin përkthehet në një bashkëpunim 360-gradësh ku gjithmonë në qendër të vëmendjes mbetet klienti.

Përveç rritjes sasiore, kemi shënuar përmirësime të ndjeshme në cilësinë e kreditimit – me një NPL prej vetëm 1.4% në total, dhe 1.0% për kreditë të biznesit, duke reflektuar një qasje gjithnjë e më prudente dhe efikase në menaxhimin e riskut.

Rritja e likuiditeteve dhe aktivitetit të klientëve në depozita dhe llogari rrjedhëse është një tregues i qartë i besimit që tregu ka ndaj nesh, duke e kthyer bashkëpunimin me ABI Bank në një marrëdhënie të plotë dhe të integruar.

Sa i takon të ardhmes, ne vazhdojmë të jemi optimistë për bankën tonë dhe ekonominë shqiptare. Me një bazë kapitali të fortë, një ekip të talentuar dhe të përkushtuar, dhe një angazhim për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e klientëve tanë, besojmë se jemi në pozicion të mirë për të vazhduar të rritemi dhe të jemi të suksesshëm në vitet që vijnë.

### Zgjerimin i portofolit të kredisë

**610** 34% në krahasim me vitin 2023  
**millionë euro**

**10%** kreditimin e bizneseve në sektorë prioritarë si turizmi, energjetika, infrastruktura dhe ndërtimi;





05

NJËSIA  
BANKARE  
RETAIL

## NJËSIA BANKARE RETAIL

Viti 2024 shënoi një performancë të jashtëzakonshme për segmentin Retail, duke reflektuar rritje të konsiderueshme të portofolit të depozitave, zgjerim të mëtejshëm të rrjetit të degëve dhe përmirësim të vazhdueshëm në cilësinë e shërbimit. Në përputhje me objektivat strategjike të bankës, fokusi kryesor i vitit ishte rritja e bazës së klientelës dhe e fondeve të qëndrueshme përmes rritjes organike dhe përmirësimeve në qasjen ndaj klientit.


Portofoli i depozitave për individë u rrit me afërsisht 15.11% krahasuar me fundvitin 2023. Kjo rritje u mundësua nga fushata të suksesshme me norma interesi konkurruese si dhe nga hapja e gjashtë degëve të reja në qytetet me potencial të lartë si Tirana, Durrësi dhe Vlora.

Sa i takon depozitave, rritja e bazës së klientëve depozitorë kombinuar me produkte inovatore dhe tërheqëse për klientët, prodhuan një rritje të portofolit të depozitave prej EUR 117.4 milionë. Si rezultat, pjesa e tregut të depozitave për individë u rrit nga 5.8% në fund të vitit 2023 në 6.18% në fund të vitit 2024.

Në një treg shumë konkurrues, veçanërisht për kreditë hipotekore, fokusi i bankës në kreditim Retail ka qenë kredihënja e kujdesshme dhe ruajtja e cilësisë së portofolit ekzistues, si dhe mbështetja për segmente të tjera si SME dhe Korporata, përmes kontributit të rrjetit të degëve.

Në total, kontributi i Retail ka qenë gjenerim kredish për të gjithë Segmentet në vlerën EUR 42 Milionë dhe ulje e normës së kredive me problem nga 5% në fund të vitit 2023 në 4.1% në fund të vitit 2024.

Trajnimet për stafin e degëve vijuan të jenë një shtyllë thelbësore e rritjes së cilësisë së shërbimit. Gjatë vitit u organizuan trajnime të shumta mbi aftësitë në shitje, produktet tradicionale dhe ato digjitale, proceset operacionale, si dhe tematika të rëndësishme si parandalimi i pastrimit të parave dhe siguria kibernetike.





06

NJËSIA E  
OPERACIONEVE

# NJËSIA E OPERACIONEVE

Gjatë vitit 2024 është vijuar me shtimin e shërbimeve në kanalet alternative dhe rritjen e përformacës operacionale të listuara si më poshtë. Përmes investimeve në kanalet alternative është synuar rritja e cilësise se shërbimit, përmirësimi i përvojës së klientit, bërjen e produkteve me atraktive si dhe rritjen e të ardhurave.

- Diversifikimi i kanaleve të pagesave: U finalizua projekti për përfshirjen e skemës MasterCard, duke bërë ATM-të të përputhshme me dy skemat më të mëdha të pagesave me kartë.
- Zgjerimi i shërbimeve për bizneset: Filloi pranimi i pagesave me kartë në POS sipas teknologjise më të fundit te POS (android OS) për klientët e biznesit, për Visa dhe MasterCard.
- Automatizimi i rinovimit të kartave të debitit: Ky proces përmirësoi shpërndarjen dhe pajisjen e klientëve me karta në mënyrë efikase.
- Partneriteti me Euronet për ATM: Ky bashkëpunim solli të ardhura shtesë dhe akses të zgjeruar në ATM-të ABI dhe Euronet me komisione të unifikuara.
- Modernizimi i platformës online: U ofruan pagesa në kohë reale (WS - Webservice) dhe pagesa utilitare, si dhe u forcua siguria administrative sipas parimit të 4 syve.
- Përputhshmëria me rregulloren e Bankës së Shqipërisë: U implementua autentikimi i sigurt për platformën online dhe për pagesat pa kontakt me kartë.

## Divizioni i Administratës dhe Prokurimeve

Viti 2024 shënon një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e zgjerimit e rrjetit të Bankës në Tiranë dhe qytete me potencial të lartë ekonomik dhe demografik, jo vetëm si rritje fizike e prezencës së Bankës, por edhe si pjesë e një transformimi tërësor drejt standardeve bashkëkohore të shërbimit dhe përvojës së klientit.

Gjatë vitit 2024, Banka është zgjeruar me 6 degë të reja, nga të cilat 4 në Tiranë, një degë në Durrës dhe një degë në Vlorë. Degët e reja janë projektuar dhe ndërtuar me një filozofi të qartë të orientuar drejt klientit, me hapësira që ndërthurin inovacionin me ndëreveprimin njerëzor, për një përvojë bankare të personalizuar dhe moderne. Në përputhje me parimet e arkitekturës moderne dhe funksionalitetit, ambientet e degëve të reja janë të hapura e të ndriçuara natyralisht, duke përfshirë zona pritjeje të rehatshme, sportele të optimizuara për shërbim të shpejtë, si dhe zona të dedikuara për këshillim financiar dhe shërbime premium.

Përmes këtyre investimeve, Banka synon të rrisë cilësinë e shërbimit, të përmirësojë përvojën e klientit dhe të forcojë imazhin e saj si një institucion modern, inovativ dhe i orientuar drejt qëndrueshmërisë.

Gjithashtu, si rezultat i shtimit të numrit të stafit, janë ndërmarrë masa për zgjerimin edhe të Zyrave qendrore me ambiente të reja, me qëllim krijimin e hapësirave shtesë pune, optimizimin e kushteve për stafin ekzistues, si dhe përmirësimin e funksionalitetit. Ky investim ka mundësuar jo vetëm akomodimin e nevojave aktuale, por edhe krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin e ardhshëm të institucionit.

Procesi i projektimit dhe ndërtimit të degëve të reja dhe hapësirave shtesë të Zyrave qendrore u menaxhua nga Divizioni i Administratës, duke siguruar ndjekjen e standardeve bashkëkohore dhe respektimin e afateve të planifikuara.

Gjatë vitit 2024, aktiviteti i divizionit të IT-së ka luajtur nje rol kyc në mbështetjen dhe avancimin e axhendës së transformimit digjital të bankës. Aktivitetet kryesore janë fokusuar në shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve në kanalet digjitale/alternative, përmirësimin e sistemeve që sigurojnë përputhshmërinë rregullatore dhe rritjen e efikasitetit operacional përmes zhvillimit dhe implementimit të sistemeve e teknologjive të reja. Fushat kryesore të aktivitetit përfshijnë:



**Zhvillimi dhe Përmirësimi i Platformave të Online dhe Mobile Banking**

Në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e biznesit janë dizenuar, zbatuar dhe lançuar funksionalitete të reja në kanalet online dhe mobile të bankës. Kjo përfshin prezantimin e shërbimeve të reja të orientuara drejt një përvojë më të gjerë e më angazhuese për klientët si individë ashtu edhe korporata, rritjen e standarteve të sigurisë me metoda të përmirësuara të autentifikimit, parimit të 4 syve, integritet me palë të treta në kohë reale etj

**Zbatimi i Open Banking/Bankingut hapur**

Në përputhje me kërkesat rregullatore, divizioni i IT-së siguroi zhvillimin dhe publikimin e APIve të sigurta, sipas standarteve të tregut, duke u mundësuar ofruesve të palëve të treta akses në pagesa dhe të dhëna të caktuara bankare. Platforma siguron përputhshmëri të plotë me standartet e PSD2 dhe kuadrin rregullator përkatës të bankës qendrore, përfshirë zbatimin e protokolleve të sigurisë sipas standardeve të industrisë. ABI ishte ndër bankat e para që realizoi daljen live dhe transaksionin e parë me TPP-në e parë të licensuar tregun shqiptar për bankingun e hapur.


**Zhvillimi i Produkteve të Reja dhe Mirëmbajtja dhe e sistemit qendror bankar**

IT-ja ka vijuar të mbështesë në mënyrë aktive lançimin e produkteve e shërbimeve të reja bankare dhe përmirësimin e tyre nëpërmjet parametrizimit të tyre në sistemin qendror bankar. Këtu mund të përmendim disa produkte specifike depozitash, POS, Master Card, integrimi me ISSH, FTL etj

Gjithashtu, sistemi qendror bankar mirëmbahet përmes përditësimeve të rregullta të planifikuara, të cilat nga njëra ana sigurojnë stabilitetin dhe performancën e tij në kushtet e rritjes së vazhdueshme të vëllimeve operacionale dhe, nga ana tjetër, sigurojnë bazën për modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve, produkteve dhe operacioneve bankare.

**Automatizimi i Proceseve**

Një nga fushat kryesore të aktivitetit të IT-së në vazhdimësi është automatizimi i proceseve të brendshme të bankës nëpërmjet implementimit dhe zhvillimit të aplikimeve dhe integritet për procese specifike, të cilat kanë reduktuar punën manuale, kanë përmirësuar kohën e përgjigjes dhe vendimmarrjes si dhe kanë rritur saktësinë e të dhënave dhe të raportimeve në aspekte të tilla si shërbimi ndaj klientit, përputhshmëria KYC/AML, thesari, manaxhimi i procesit të vlerësimit të performancës 360° etj.





P7

BURIMET  
NJERËZORE

## BURIMET NJERËZORE

### Punonjësit në ABI Bank

Me një ekip prej rreth 400 punonjësish, ABI Bank pozicionohet si një punëdhënës që promovon një mjedis pune konkurrues dhe tërheqës, duke u fokusuar në kompensimin e drejtë, zhvillimin profesional dhe motivimin e vazhdueshëm të stafit.

Divizioni i Burimeve Njerëzore është i përkushtuar në krijimin dhe ruajtjen e një ambjenti pune që nxit përfshirjen, zhvillimin dhe angazhimin profesional të punonjësve, në përputhje me standardet më të mira të industrisë bankare. Kjo përfshin programe mentorimi, trajnime të vazhdueshme dhe mundësi për avancim në karrierë, duke siguruar që çdo punonjës të ketë të qartë rrugën e tij të zhvillimit profesional.

Gjatë vitit 2024, punonjësit tanë kanë demonstruar përkushtim dhe aftësi të larta profesionale në përmbushjen e objektivave strategjike të bankës, duke kontribuar ndjeshëm në arritjen e rezultateve të synuara. Ky sukses është rezultat i një kulture organizative që vlerëson dhe shpërblen performancën, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërmjet ekipeve.

ABI Bank, e orientuar drejt modelit të bankës butik, karakterizohet nga një qasje e personalizuar dhe e përqëndruar në ofrimin e shërbimeve të përshtatura për nevojat e klientit. Kjo qasje përfaqëson një filozofi të qëndrueshme në kulturën organizative të bankës, ku çdo punonjës ndjen vlerësimin dhe ndikimin e tij në suksesin e përgjithshëm të institucionit.

Gjatë vitit 2024, në përputhje me politikat e bankës për punësim dhe trajtim në mënyrë të barabartë, 124 punonjës kanë gjetur mundësi punësimi afatshkurtra ose afatgjata brenda institucionit tonë, përmes proceseve të strukturuar dhe transparente të rekrutimit. Kjo tregon angazhimin tonë për të ofruar mundësi të barabarta dhe për të ndërtuar një ekip të larmishëm dhe të aftë.



### Rekrutimet në ABI

Gjatë vitit 2024, ABI Bank ka thelluar angazhimin e saj në ndërtimin e një force punëtore të kualifikuar dhe të përkushtuar, duke e pozicionuar veten si një punëdhënës i preferuar në tregun bankar shqiptar. Si një bankë butik, ABI i kushton rëndësi të veçantë përzgjedhjes së kandidatëve që përputhen me kulturën organizative dhe objektivat strategjike të institucionit.

Procesi i rekrutimit në bankë fillon me një analizë të detajuar të nevojave organizative dhe objektivave afatgjata. Kjo qasje siguron që çdo pozicion i ri të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e misionit të bankës në ofrimin e shërbimeve të personalizuar dhe cilësore. Në kuadër të zgjerimit të rrjetit të degëve dhe përmirësimit të shërbimeve për klientët, ABI Bank ka intensifikuar proceset

e rekrutimit gjatë vitit 2024. Fokusi është vendosur në identifikimin dhe integrimin e talentëve me potencial të lartë, të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të institucionit.

Proceset e rekrutimit në ABI janë të ndërtuara mbi parimet e transparencës, integritetit dhe profesionalizmit, duke siguruar që çdo kandidat të vlerësohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, në përputhje me standardet më të mira të industrisë bankare.

Divizioni i Burimeve Njerëzore është i angazhuar në promovimin e diversitetit dhe përfshirjes në vendin

e punës, duke u siguruar që proceset e rekrutimit të jenë të hapura dhe të aksesueshme për të gjithë kandidatët, pavarësisht prejardhjes, gjinisë apo statusit social.

Në këtë mënyrë, ABI Bank jo vetëm që përmbush detyrimet e saj ligjore dhe etike, por gjithashtu ndërton një reputacion të fortë si një punëdhënës i besueshëm dhe i drejtë, në përpjekje për të tërhequr dhe mbajtur talentet më të mira në tregun bankar shqiptar.

### Funksione e aktivitete të Burimeve Njerezore

ABI Bank e konsideron zhvillimin profesional të punonjësve si një komponent kyç në realizimin e objektivave të saj strategjik. Divizioni i Burimeve Njerezore është i angazhuar në implementimin e programeve të trajnimit që përputhen me nevojat e biznesit dhe aspiratat individuale të stafit. Këto programe, të realizuara në bashkëpunim me eksperte të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, synojnë përmirësimin e aftësive teknike dhe menaxheriale të punonjësve, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve bankare.

Përveç zhvillimit profesional, Divizioni i Burimeve Njerezore, promovon një kulturë organizative që vlerëson përfshirjen dhe mirëqënien e stafit përmes organizimit të eventeve e aktiviteteve të ndryshme, si "Dita Ndërkombëtare e Gruas", "Festa e Pavarësisë së Amerikës", "Halloween Party", "Festa e Fundvitit" dhe evente të tjera.

Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes së artit dhe kulturës, banka, si sponsor i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Teatrit ArTurbin, u ofron punonjësve mundësinë për të ndjekur premierat dhe shfaqjet artistike, duke kontribuar në pasurimin kulturor dhe social të stafit.

Këto iniciativa reflektojnë përkushtimin e ABI Bank për të krijuar një ambient pune që nxit zhvillimin profesional dhe mirëqënien e punonjësve, duke kontribuar në suksesin dhe qëndrueshmërinë e institucionit.



### Respektimi i diversitetit

Banka ka implementuar politika të qarta për të siguruar që çdo punonjës të trajtohet me dinjitet, respekt dhe në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga gjinia, mosha, pëkatësia etnike, aftësia e kufizuar apo bindjet fetare. Divizioni i Burimeve Njerezore synon të krijojë një kulturë organizative që vlerëson përfshirjen dhe mirëqënien e stafit, duke promovuar krijimin e një ambjenti pune që nxit përfshirjen, zhvillimin dhe angazhimin profesional të punonjësve, në përputhje me standardet më të mira të industrisë bankare.

ABI Bank është një ndër të vetmet banka në sistemin bankar, bordin e së cilës drejton një anëtare femër. Gjithashtu, në vitin 2024, gratë përbëjnë 76% të forcës punëtore të ABI Bank dhe 58% të menaxhmentit të lartë, duke dëshmuar përkushtimin e bankës ndaj promovimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në pozicione udhëheqëse. Ky përfaqësim i lartë i grave në nivelet drejtuese është një tregues i qartë i përpjekjeve të vazhdueshme të bankës për të krijuar një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe të barabartë. Përtej strukturave të brendshme, ABI Bank ka mbështetur projekte dhe iniciativa që synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave në komunitet.

ABI Bank, në vitin 2024, ka forcuar më tej angazhimin e saj për barazinë gjinore dhe përfshirjen, duke e konsideruar diversitetin si një shtyllë themelore të suksesit dhe qëndrueshmërisë së institucionit. Ky përkushtim është reflektuar në mënyrë të dukshme në strukturat drejtuese dhe në politikat e brendshme të bankës.



08

Përgjegjësia  
Sociale e  
Korporatës 2024

## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024

### ABI Bank dhuron gjak

Stafi i ABI Bank iu bashkua sërish me shumë dashuri dhe përgjegjshmëri, nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar, për dhurim gjaku vullnetar në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

### Mbështetje për shoqatën e të verbërve të Shqipërisë

Projekti “të-verbër-por-të-etur-për-të-lexuar” i zbatuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë synon ndarjen e një pasioni të përbashkët: dëshira e të verbërve për të eksploruar botën përmes faqeve të librave.

### Mbështetje e projektit “Së Bashku Ne Mundemi Të Ngjimis Edhe Malin Më Të Lartë!”

ABI Bank ka mbështetur projektin “Së Bashku Ne Mundemi Të Ngjimis Edhe Malin Më Të Lartë!” në mbrojtje të vajzave dhe grave, viktimat të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Ky projekt është pjesë e një lëvizjeje globale, e nxitur nga besimi se së bashku ne mund të ngjitemi edhe në majat më të larta.

### Fondacioni “Misioni Emanuel”

Abi Bank ka mbështetur projektin “E ardhmja për fëmijët” me qëllim promovimin për zhvillimin dhe mbështetjen publike ndaj grupeve në nevojë për një periudhë 1 vjeçare.

Programi zhvillohet në qytetin e Korçës dhe konsiston në mbështetjen e 100 fëmijëve të grupmoshës 6-15 vjeç përmes programeve të dedikuara në qendrat ditore të hapura për fëmijët të cilët vijnë nga familje të marginalizuara.

### ABI Bank mbështet “A night of color”

Më 16 maj, Hotel Plaza priti darkën e përvitshme gala “A night of color”, organizuar nga aktivistë të komunitetit LGBT në Tiranë. Në luftën kundër diskriminimit, ABI mbështeti për të shtatin vit radhazi këtë aktivitet bamirësie, misioni i të cilit është të sigurojë fonde dhe vazhdimësi akomodimi, ushqimi, mbështetje psiko-sociale, trajnime gjatë gjithë jetës, edukim dhe punësim për të rinjtë LGBT që jetojnë në Qendra Strehë dhe që kanë rënë viktimat të abuzimit dhe diskriminimit.

### Fondacioni i Nënës dhe Fëmijës

Abi Bank ka mbështetur projektin në ndihmë të Nënave dhe Bebeve të sapolindura në nevojë, në 2 maternitete publike në Tiranë, për blerjen e materialeve spitalore që u vijnë në ndihmë në ditët e para të jetës.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024

### ABI mbështet Down Syndrome Albania

Fondacioni Down Syndrome Albania organizoi koncertin e bamirësisë në të cilën ABI Bank mori pjesë si sponsor duke treguar mbështetjen e vazhdueshme që jep për kauza të ndryshme sociale dhe shtresat në nevojë të komunitetit tonë.

### "Harmonia e Fëmijërisë" – ABI Bank mbështeti projektin për ndërtimin e një qendre ditore për fëmijët në Rrëshen

ABI Bank ishte pjesë e ankandit "Rrathë Dhurues" të organizuar për vitin e gjashtë radhazi nga Partners Albania. Në këtë event ABI mbështeti projektin "Harmonia e Fëmijërisë" që synon ndërtimin e një qendre ditore në Rrëshen për ofrimin e mbështetjes dhe aktiviteteve edukative, kreative dhe sportive për 700 nxënës duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe përfshirjen sociale.

### "Ajo sheh muzikën" – ABI Bank mbështeti koncertin gjithëpërfshirës organizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

ABI Bank është përkushtuar të mbështesë aktivitete që frymëzojnë dhe promovojnë barazinë dhe përfshirjen sociale. Ky koncert bëri bashkë performancat e artistëve me aftësi ndryshe krah për krah me artistë të tjerë, ku dhe u përcollën mesazhe fuqie, bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirje.

### Zë me Mirën Podcast

ABI Bank ka mbështetur podcast-in "Zë me Mirën", të gazetares Mira Kazhani, për vetë fokusin që ky podcast ka, i cili pasqyron një sërë tematikash sociale, kulturore si dhe rrëfime personale, motivuese dhe informuese.

### Java e Parasë – 2024

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti në Javën e Parasë konkursin nën sloganin: "Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde!". Pjesëmarrës në këtë konkurs me projektet e tyre, ishin nxënësit e klasave të treta nga shkolla të ndryshme të gjithë vendit, të cilët u angazhuan në trajtimin e kësaj teme.

ABI Bank mbështet gjithmonë projektet që kanë në vëmendje edukimin financiar të brezave të ardhshëm.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024

### Hackathon-Identitek

Stafi i ABI Bank iu bashkua me shumë dashuri dhe përgjegjshmëri, nismës së "Identitek", për projektet inovative të 9 grupeve të rinjsh nga 9 Universitete mbi digitalizimin e shërbimeve të ndryshme për dokumentat e identifikimit, digitalizimin e shërbimeve shëndetësore, etj.

### Konferenca Ndërkombëtare e Informimit - Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

ABI Bank mbështeti edicionin e 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Informimit organizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave. Përfshirja në këtë event tregon angazhimin e Bankës në promovimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në shoqëri.

### Krijimi i partneritetit efektiv ndërmjet shoqërisë civile dhe biznesit

ABI Bank mori pjesë në eventin "Krijimi i partneritetit efektiv midis shoqërisë civile dhe biznesit", organizuar nga Partnerët Shqiptar me synimin për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe partneriteti midis shoqërisë civile dhe sektorëve të biznesit me një kontribut në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 70 përfaqësues të sektorit të biznesit dhe OJQ-ve. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës së Filantropisë.

### Qendra e Artit dhe Kulturës, Korçë

Abi Bank mbështeti eventin me mbulimin e shpenzimeve për foninë në inagurimin e "Qendrës së Artit dhe Inovacionit", Korçë.

### Swing Marathon 6<sup>th</sup> Edition

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti "Swing Marathon" organizuar nga "Shoqata Hemingway Fun Club", për të 6-in edicion në qytetin e Shkodrës. ABI Bank mbështet gjithmonë projektet që kanë në vëmendje zhvillimin dhe promovimin e qyteteve tona.

### Maratona "Këngë Moj"

ABI Bank mbështeti Maratonën "Këngë Moj" të zhvilluar në qytetin e Gjirokastrës me pjesëmarrjen e ikonave të muzikës qytetare folklorike popullore dhe të lehtë, duke promovuar zhvillimin kulturor dhe ekonomik të qyteteve shqiptare dhe trashëgiminë kulturore.

### Hemingway Jazz Fest

Për të disatin vit radhazi ABI Bank ishte sponsor i përgjithshëm i edicionit të 11-të të "Hemingway Jazz Fest", organizuar në Oborrin e Universitetit Politeknik të Tiranës në dt 19-21 korrik me pjesëmarrjen e jashtëzakonshme të yjeve botëror të xhazit.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024

### Koncert - Elvina Kocillari

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti pianisten e njohur Elvina Kocillari në koncertin e saj të zhvilluar në Fakultetin e Arteve.

### Sunset City Melodies

Abi Bank mbështeti dy muzikantë të talentuar të cilët së bashku me violinistin shqiptaro-francez Kledis Rexho performuan në një eksperiencë unike me tingujt e muzikës klasike, folk dhe barok bazuar në filmat dhe muzikën e vendit tonë.

### ABI BANK sponsor i Teatrit Kombëtar

ABI Bank është sponsor zyrtar i Teatrit Kombëtar, i angazhuar në mbështetje të artit, kulturës dhe artistëve shqiptarë, si pjesë e angazhimit tonë ndaj komunitetit dhe vlerave kulturore.

### Ekrani i artit Shkodër

ABI Bank mbështeti Festivalin “Ekran i Artit Shkodër”, i cili u zhvillua në datat 5-9 qershor në qytetin e Shkodrës. Në këtë edicion të 45-të, festivali solli 45 filma, 3 ekspozita, 4 instalacione dhe biseda e orë të hapura me artistë e të ftuar.

### Koncerti “Rikthimi i Dallëndyshe” - Ermonela Jaho

Sopranoja e njohur në botë, Ermonela Jaho, u kthye në Shqipëri me koncertin “Rikthimi i Dallëndyshe” në Teatrin e Operas dhe Baletit. ABI Bank ishte sponsor i përgjithshëm i këtij koncerti.

### Festa e Birrës

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti edicionin e 18-të të Festës së Birrës në Korçë. Festivali u zhvillua në datë 14- 18 gusht 2024 me pjesëmarrje të shumë artistëve të njohur shqiptar dhe të huaj.

### ABI BANK sponsor i përgjithshëm i TKOBP

ABI Bank është sponsor i përgjithshëm i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit për të pestin vit radhazi. Ne besojmë në fuqinë e artit për të sjellë ndryshime pozitive në komunitet.

### Ekspozita “Sogno Divino” pranë Naan Gallery

ABI Bank ka mbështetur ekspozitën e quajtur “Sogno Divino”, një ekspozitë e cila ofroi për të gjithë artdashësit, për herë të parë në Shqipëri, 100 veprat origjinale të artistit surrealist Salvador Dali të cilat ilustrojnë “Komedinë Hyjnore” të Dante Alighierit. Përmes mbështetjes ABI Bank synon të frymëzojë e përafrojë komunitetin me artin.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE  
E KORPORATËS 2024

**Festivali i 63-të  
i Këngës në RTSH**

Përgjatë datave 19 – 22 dhjetor, u zhvillua edicioni i 63-të i Festivalit të përvitshëm të muzikës shqiptare, ABI Bank si mbështetës i vazhdueshëm i aktiviteteve artistike e kulturore, gjatë këtij viti ka qënë sponsorizues edhe i Festivalit të Këngës, i cili nuk përcolli vetëm muzikë e performancë por edhe mesazhe të forta sensibilizuese përmes personazheve të ndryshëm publikë.

**Kosmos Music Festival**

ABI Bank ka mbështetur Kosmos Music Festival, një festival dedikuar muzikës klasike dhe asaj të dhomës. Me pjesëmarrjen e artistëve të njohur vendas dhe të huaj u organizuan 4 koncerte në datat 26 – 30 tetor. Kjo nismë përputhet me angazhimin e ABI Bank në mbështetje të artit dhe promovimin e zhvillimit kulturor në komunitet.

**Porto Palermo Festival**

ABI Bank mbështeti “Porto Palermo Festival” i cili u organizua në kalanë e Porto Palermos në datat 1 deri në 18 gusht 2024. Arti, trashëgimia kulturore, historia dhe natyra bëhen bashkë në edicionin e katërt të këtij festivali.

**Master class by Terrence  
McNally**

Eva Alikaj solli në skenën e Teatrit të Operas dhe Baletit shfaqjen “Master class by Terrence McNally”. ABI Bank ishte mbështetës i kësaj shfaqjeje.

**Festa e Pavarësisë së Shteteve  
të Bashkuara të Amerikës**

Për të disatin vit radhazi, Banka Amerikane e Investimeve ishte partneri kryesor i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë, në organizimin e ceremonisë festive me rastin e festës së Pavarësisë së SHBA-ve.

**“Të Fshehta jashtë Ekranit” -  
Mevlan Shanaj**

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti botimin e librit me titull “Te Fshehta jashtë Ekranit” një përmbledhje impresioneve dhe esesh për filmin, ku kanë spikatur emrat më të njohur të kinematografisë duke lëvruar vlerat që ata kanë dhënë.

**Konkursi i DPSHTRR-së  
“Transport, Inovacion dhe  
Siguri”**

ABI Bank është bërë pjesë e iniciativës së DPSHTRR-së, duke mbështetur konkursin “Transport, Inovacion dhe Siguri”, i cili synoi përfshirjen e studentëve në përmirësimin e sektorit të transportit rrugor përmes inovacionit dhe teknologjisë moderne.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS 2024

### Restaurimi i Kishës Shën Nikolla në Vuno, Himarë



Restaurimi i Kishës Shën Nikolla në Vuno është një tjetër kontribut i ABI Bank për ruajtjen e vlerave historike dhe kulturore të vendit tonë. Me mbështetjen financiare të ABI Bank, ky projekt e riktheu kishën në një gjendje funksionale, duke siguruar mbrojtjen e vlerave të saj historike dhe trashëgiminë për brezat e ardhshëm.

### Forumi Urban i Tiranës

ABI Bank gjatë datave 6-7 dhjetor, ka mbështetur Forumin Urban të Tiranës, i cili priti kryetarë të Bashkive, zyrtarë nga rajoni B40, një grup ekspertësh teknikë si dhe lider të mendimit mbi urbanizimin. Gjatë forumit u zhvilluan ligjërata të hapura për publikun, ëorkshop-e, eskursione të udhëhequra, për të ndarë njohuri dhe frymëzuar liderat e qyteteve si nxitës të ndryshimit urban duke investuar në mirëqënien e familjeve e veçanërisht fëmijëve. ABI Bank ka qenë dhe është gjithmonë e angazhuar ndaj zhvillimit urban dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës.

### Dokumentar “Në Besë të Shqiptarëve”

Duke besuar në rëndësinë e madhe që arti e kultura ka, në përçimin e vlerave të vendit tonë, ABI Bank ka mbështetur dokumentarin e realizuar nga Rudina Xhunga dhe Dritare TV, “Në Besë të Shqiptarëve”, një vepër që vlerëson historinë, kulturën dhe traditën e mikpritjes shqiptare.






p9

RRJETI I  
DEGËVE

Rrjeti i Degëve

|    |                                    |    |                                   |                              |
|----|------------------------------------|----|-----------------------------------|------------------------------|
| 1  | Tiranë<br>Dega Qendrore            | 12 | Tiranë<br>Dega "Ali Demi"         |                              |
| 2  | Tiranë<br>Dega "Samos Tower"       | 13 | Durrës<br>Dega Durrës             |                              |
| 3  | Tiranë<br>Dega "Bajram Curri"      | 14 | Dega Durrës Egnatia               |                              |
| 4  | Tiranë<br>Dega "Qendra Pajtoni"    | 15 | Fier<br>Dega Fier                 |                              |
| 5  | Tiranë<br>Dega "Komuna e Parisit"  | 16 | Elbasan<br>Dega Elbasan           |                              |
| 6  | Tiranë<br>Dega "Rruga e Dibrës"    | 17 | Gjirokastër<br>Dega Gjirokastër   |                              |
| 7  | Tiranë<br>Dega "Sheshi Shtraus"    | 18 | Lezhë<br>Dega Lezhë               | 23 Pogradec<br>Dega Pogradec |
| 8  | Tiranë<br>Dega "21 Dhjetori"       | 19 | Kavajë<br>Dega Kavajë             | 24 Berat<br>Dega Berat       |
| 9  | Tiranë<br>Dega "Kamëz"             | 20 | Korçë<br>Dega Korçë               | 25 Shkodër<br>Dega Shkodër   |
| 10 | Tiranë<br>Dega "Stacioni i Trenit" | 21 | Vlorë<br>Dega Vlorë               | 26 Lushnje<br>Dega Lushnje   |
| 11 | Tiranë<br>Dega "Astir"             | 22 | Vlorë<br>Dega "Sheshi i Flamurit" | 27 Sarandë<br>Dega Sarandë   |





10

PASQYRAT  
FINANCIARE

BANKAAMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Pasqyrat Financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më  
31 dhjetor 2024  
(me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

|                                                                                 |    |
|---------------------------------------------------------------------------------|----|
| PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR                                        | 1  |
| PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRSHIRËSE | 2  |
| PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL                                      | 3  |
| PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE                                           | 4  |
| 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM                                                   | 5  |
| 2. BAZAT E PËRGATITJES                                                          | 5  |
| 3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL                                             | 7  |
| 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL                                   | 8  |
| 5. MANAXHIMI I RREZIKUT                                                         | 25 |
| 6. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL                             | 48 |
| 7. VLERË E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE                          | 51 |
| 8. ANALIZA E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE SIPAS MATURITETIT TË MBETUR                | 53 |
| 9. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE                                      | 54 |
| 10. HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE                                                  | 54 |
| 11. INVESTIME FINANCIARE NË LETRA ME VLERË                                      | 55 |
| 12. HUATË DHE PARADHËNIET DHËNË KLIENTËVE                                       | 61 |
| 13. QIRA FINANCIARE                                                             | 66 |
| 14. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE E DREJTA E PERDORIMIT TË AKTIVEVE            | 68 |
| 15. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE                                               | 69 |
| 16. INVENTARI DHE AKTIVE TË TJERA                                               | 69 |
| 17. INVESTIME NË PJESËMARRJE DHE FILIALE                                        | 70 |
| 18. DETYRIME NDAJ BANKAVE                                                       | 70 |
| 19. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE                                                     | 71 |
| 20. BORXHI I VARUR                                                              | 72 |
| 21. AKTIVE DHE DETYRIME TATIMORE TË SHTYRA                                      | 72 |
| 22. PROVIZONE TË TJERA                                                          | 73 |
| 23. DETYRIME TË TJERA                                                           | 73 |
| 24. KAPITALI AKSIONAR                                                           | 73 |
| 25. REZERVAT                                                                    | 74 |
| 26. TË ARDHURA NGA INTERESAT, NETO                                              | 75 |
| 27. TË ARDHURA NGA TARIFAT DHE KOMISIONET, NETO                                 | 76 |
| 28. TË ARDHURA TË TJERA, NETO                                                   | 76 |
| 29. SHPENZIMET PERSONELI                                                        | 76 |
| 30. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE                                           | 77 |
| 31. TATIM FITIMI                                                                | 77 |
| 32. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA                                       | 78 |
| 33. ÇËSHTJE LIGJORE                                                             | 79 |
| 34. ANGAZHIMET PËR QIRATË DHE SHPENZIMET PËR QIRATË OPERATIVE                   | 79 |
| 35. TRANSAKSIONET E PALEVË TË LIDHURA                                           | 79 |
| 36. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT                                               | 82 |



Grant Thornton Sh.p.k.  
Rr. "Sami Frashëri",  
Kompleksi T.I.D, Shk. F, Floor 1  
1001 Tirana  
Albania  
  
T +355 44 525 880  
E contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët dhe Bordin Drejtues të “Banka Amerikane e Investimeve sh.a.”

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të “Banka Amerikane e Investimeve sh.a” (këtu e më poshtë referuar “Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu :

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare të veçanta, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të veçanta ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

### **Grant Thornton sh.p.k.**

Tiranë, Shqipëri

13 maj 2025

*Mediana Koka, FCPA*



Grant Thornton  
Sh.p.k.  
KPT  
K 91923007 M  
Tirana  
Albania

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

| Shënime                                                          | 31 dhjetor 2024 | 31 dhjetor 2023    |
|------------------------------------------------------------------|-----------------|--------------------|
|                                                                  | Lekë '000       | Lekë '000          |
| <b>Aktivet</b>                                                   |                 |                    |
| Mjete monetare dhe të ngjashme me to                             | 9               | 7,840,680          |
| Hua dhe paradhënie për bankat                                    | 10              | 6,864,658          |
| Investime financiare – VDATGJ                                    | 11              | 24,181,542         |
| Investime financiare me kosto të amortizuar                      | 11              | 36,883,810         |
| Hua dhe paradhënie dhënë klientëve                               | 12              | 58,825,758         |
| Qira financiare                                                  | 13              | 331,292            |
| Aktive afatgjata materiale dhe e drejta e përdorimit të aktiveve | 14              | 2,302,799          |
| Aktive afatgjata jo-materiale                                    | 15              | 123,633            |
| Aktive tatimore të shtyra                                        | 21              | -                  |
| Inventari dhe aktive të tjera                                    | 16              | 3,248,103          |
| Investime në pjesëmarrje dhe filiale                             | 17              | 120,500            |
| <b>Totali i aktiveve</b>                                         |                 | <b>140,722,775</b> |
|                                                                  |                 | <b>130,819,006</b> |
| <b>Detyrimet</b>                                                 |                 |                    |
| Detyrime ndaj bankave                                            | 18              | 22,401,235         |
| Detyrime ndaj klientëve                                          | 19              | 100,510,426        |
| Detyrime të tjera                                                | 23              | 2,483,820          |
| Detyrime të qirasë                                               |                 | 1,130,398          |
| Provizione të tjera                                              | 22              | 56,438             |
| Detyrim tatimor i shtyrë                                         | 21              | 58,998             |
| Borxhi i varur                                                   | 20              | 1,706,974          |
| <b>Totali i detyrimeve</b>                                       |                 | <b>128,348,289</b> |
|                                                                  |                 | <b>119,503,323</b> |
| <b>Kapitali</b>                                                  |                 |                    |
| Kapitali aksionar                                                | 24              | 3,450,935          |
| Rezerva ligjore dhe të tjera                                     | 25              | 5,252,555          |
| Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë                        | 25              | 434,869            |
| Fitim i akumuluar                                                |                 | 30,460             |
| Fitimi i vitit                                                   |                 | 3,205,667          |
| <b>Totali i kapitalit</b>                                        |                 | <b>12,374,486</b>  |
| <b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>                         |                 | <b>140,722,775</b> |
|                                                                  |                 | <b>130,819,006</b> |

Shënimet shpjeguese bashkëlidhur në faqet 5 deri në 82 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRSHIRËSE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

| Shënime                                                                                        | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023 |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
|                                                                                                | Lekë '000                         | Lekë '000                         |
| Të ardhura nga interesat                                                                       | 7,423,594                         | 6,330,712                         |
| Shpenzime për interesa                                                                         | (2,128,011)                       | (1,977,859)                       |
| <b>Të ardhura nga interesat, neto</b>                                                          | <b>5,295,583</b>                  | <b>4,352,853</b>                  |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| Të ardhura nga tarifa dhe komisione                                                            | 606,188                           | 422,552                           |
| Shpenzime për tarifa dhe komisione                                                             | (147,235)                         | (79,600)                          |
| <b>Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto</b>                                             | <b>458,953</b>                    | <b>342,952</b>                    |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| Rezultati neto nga veprimet me valutat                                                         | 222,138                           | (124,488)                         |
| (Humbje)/ të ardhura të tjera operative, neto                                                  | 459,760                           | 355,710                           |
| <b>Të ardhura të tjera, neto</b>                                                               | <b>681,898</b>                    | <b>231,222</b>                    |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| Rimarrje/(shpenzim) nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet dhënë klientëve                    | (335,309)                         | 217,953                           |
| Humbje nga zhvlerësimi i aktiviteteve financiare të tjera                                      | 138,345                           | (19,363)                          |
| Zhvlerësimi neto i zerave jashtë bilancit                                                      | (1,775)                           | 2,402                             |
| Shpenzime personeli                                                                            | (1,210,883)                       | (972,221)                         |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi                                                                     | (306,639)                         | (267,923)                         |
| Shpenzime të tjera administrative                                                              | (942,531)                         | (755,629)                         |
| Provizioni për rreziqe dhe shpenzime, neto                                                     | (36)                              | -                                 |
| <b>Totali i shpenzimeve</b>                                                                    | <b>(2,658,828)</b>                | <b>(1,794,781)</b>                |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| <b>Fitimi neto, përpara tatim fitimit</b>                                                      | <b>3,777,606</b>                  | <b>3,132,246</b>                  |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| Shpenzimi i tatim fitimin                                                                      | (571,939)                         | (456,792)                         |
| <b>Fitimi neto i vitit</b>                                                                     | <b>3,205,667</b>                  | <b>2,675,454</b>                  |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| <b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>                                                   |                                   |                                   |
| <i>Zërat që janë ose mund të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit humbjeve</i>                 |                                   |                                   |
| Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare, (VDATGJ) neto nga tatimi mbi fitimin | 496,019                           | 33,380                            |
| <b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>                                         | <b>496,019</b>                    | <b>33,380</b>                     |
|                                                                                                |                                   |                                   |
| <b>Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>                                | <b>3,701,686</b>                  | <b>2,708,834</b>                  |

Shënimet shpjeguese bashkëlidhur në faqet 5 deri në 82, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare të veçanta janë aprovuar më 19 mars 2025 nga Drejtimi i Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. dhe janë nenshkruar në emër të tyre nga:

Andi Ballta  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Armand Muharremi  
Drejtor i Divizionit të Financës



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

|                                                                   | Kapitali<br>aksionar | Rezerva<br>ligjore dhe të<br>tjera | Rezerva e<br>vlerës së<br>drejtë | Fitim i<br>akumuluar | Totali             |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------|------------------------------------|----------------------------------|----------------------|--------------------|
|                                                                   | ALL '000             | ALL '000                           | ALL '000                         | ALL '000             | ALL '000           |
| Gjendja më 1 janar 2023                                           | 3,450,935            | 4,939,312                          | (94,530)                         | 2,926,947            | 11,222,664         |
| Fitimi i vitit                                                    |                      |                                    | -                                | 2,675,454            | 2,675,454          |
| Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë                  | -                    | -                                  | 33,380                           | -                    | 33,380             |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>                    |                      |                                    | <b>33,380</b>                    | <b>2,675,454</b>     | <b>2,708,833</b>   |
| <b>Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital</b>   |                      |                                    |                                  |                      |                    |
| Shpërndarje dividendi                                             | -                    | -                                  | -                                | (2,615,814)          | (2,615,814)        |
| Rritje e rezervës ligjore                                         | -                    | 307,053                            | -                                | (307,053)            | -                  |
| <b>Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve</b> | <b>-</b>             | <b>307,053</b>                     | <b>-</b>                         | <b>(2,922,869)</b>   | <b>(2,615,816)</b> |
| Gjendja më 31 dhjetor 2023                                        | 3,450,935            | 5,246,363                          | (61,149)                         | 2,679,534            | 11,315,683         |
| Fitimi i vitit                                                    |                      |                                    | -                                | 3,205,667            | 3,205,667          |
| Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë                  | -                    | -                                  | 496,019                          | -                    | 496,019            |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>                    | <b>-</b>             | <b>-</b>                           | <b>496,019</b>                   | <b>3,205,667</b>     | <b>3,701,686</b>   |
| <b>Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital</b>   |                      |                                    |                                  |                      |                    |
| Shpërndarje dividendi                                             | -                    | -                                  | -                                | (2,642,883)          | (2,642,883)        |
| Rritje e rezervës ligjore                                         | -                    | 6,191                              | -                                | (6,191)              | -                  |
| <b>Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve</b> | <b>-</b>             | <b>6,191</b>                       | <b>-</b>                         | <b>(2,649,074)</b>   | <b>(2,642,883)</b> |
| Gjendja më 31 dhjetor 2024                                        | 3,450,935            | 5,252,554                          | 434,870                          | 3,236,127            | 12,374,486         |

Shënimet shpjeguese bashkëlidhur në faqet 5 deri në 82, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

| Shënime                                                               | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2024 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2023 |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| <b>Fitimi përpara tatimit</b>                                         | <b>3,777,606</b>                     | <b>3,132,246</b>                     |
| <b>Rregullime për:</b>                                                |                                      |                                      |
| Amortizimi dhe zhvlerësimi                                            | 14,15                                | 306,639                              |
| Fitimi nga zhvlerësimi neto i huave dhe paradhënieve dhënë klientëve  | 12                                   | 337,084                              |
| Zhvlerësimi neto i aktiveve të tjera financiare dhe aktiveve të tjera | 11                                   | (52,708)                             |
| Humbja neto nga zhvlerësimi i provizioneve të tjera operative         | 22                                   | 36                                   |
| Të ardhura nga interesat, neto                                        | 26                                   | (5,295,583)                          |
| Diferencat e parealizuara nga kursi i këmbimit                        |                                      | (222,138)                            |
| <b>Ndryshime në:</b>                                                  |                                      |                                      |
| Hua dhe paradhënie ndaj bankave                                       | 10                                   | 704,489                              |
| Rezerva e detyrueshme                                                 | 10                                   | 205,280                              |
| Hua dhe paradhënie dhënë klientëve                                    | 12                                   | (9,540,806)                          |
| Qiraja Financiare                                                     | 13                                   | 69,835                               |
| Detyrime ndaj bankave                                                 | 19                                   | (5,214,419)                          |
| Detyrime ndaj klientëve                                               | 20                                   | 7,088,684                            |
| Inventari dhe mjete të tjera                                          | 16,17                                | 334,549                              |
| Provizione dhe detyrime të tjera                                      | 22,23                                | 494,303                              |
| Interesa të arkëtuara                                                 |                                      | 7,547,909                            |
| Interesa të paguara                                                   |                                      | (2,102,480)                          |
| Tatim i paguar mbi të ardhurat                                        |                                      | (571,939)                            |
| <b>Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative</b>                  | <b>(2,133,659)</b>                   | <b>14,662,903</b>                    |
| <b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese:</b>                    |                                      |                                      |
| Investime në pjesëmarrje dhe filiale                                  | 20                                   | (59,665)                             |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale                                 | 14                                   | 187,415                              |
| Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale                              | 15                                   | (72,538)                             |
| Blerje e investimeve financiare – VDATGJ                              | 11                                   | 3,461,701                            |
| Blerjet e investimeve financiare me kosto të amortizuar               | 11                                   | 1,918,476                            |
| <b>Fluksi monetar neto nga aktivitetet investuese</b>                 | <b>5,435,388</b>                     | <b>(14,481,837)</b>                  |
| <b>Fluksi monetar nga aktivitetet financuese</b>                      |                                      |                                      |
| Shpërndarje dividendi                                                 |                                      | (2,642,883)                          |
| <b>Fluksi monetar neto nga aktivitetet financuese</b>                 | <b>(2,642,883)</b>                   | <b>(2,615,814)</b>                   |
| <b>Zvogëlimi neto në mjete monetare dhe të ngjashme</b>               | <b>658,847</b>                       | <b>(2,434,748)</b>                   |
| Mjete monetare dhe të ngjashme me to më 1 janar                       | 9                                    | 7,181,833                            |
| <b>Mjete monetare dhe të ngjashme me to më 31 dhjetor</b>             | <b>9</b>                             | <b>7,840,680</b>                     |

Shënimet shpjeguese bashkëlidhur në faqet 5 deri në 82, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (“Banka”), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit sh.p.k.,(i zotëruar më tej nga fonde investimi të menaxhuara nga Moscopole INC me perfitues fundor Z. Andi Ballta, New Century Holdings XI, L.P dhe NCH Balkan Fund, L.P.) një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron mundësi financimi për shoqëritë dhe individët.

Banka u krijua fillimisht si një degë e Bankës Tregtare të Greqisë (më pas e quajtur Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në tetor 1998. Në tetor 1999, Banka, duke u quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania sh.a., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) sh.a. Më 1 mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.a.

Në qershor të vitit 2012, Banka Emporiki e Greqisë S.A. i shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. IUB Holding është një shoqëri anonime Franceze “par actions simplifiée”, 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Në 3 shtator të vitit 2012 emri i Bankës ndryshoi në Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.. Në tetor të vitit 2015, IUB Holding shiti 100% të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të filialit të saj, Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a., tek Tranzit sh.p.k.. Miratimet e Rregullatorit, duke përfshirë dhe ndryshimin e emrit në Banka Amerikane e Investimeve sh.a., u finalizuan me efekt ligjor në datën 12 tetor 2015.

Më 2 shkurt 2018, Banka nënshkroi marrëveshjen për blerjen 100% të aksioneve të Banka NBG Albania sh.a. Procesi i blerjes u finalizua më 3 korrik 2018 në vijim të aprovimit paraparak të Bankës së Shqipërisë më 6 qershor 2019. Në vijim të vendimi të Bordit të Aksionareve, në 6 shtator 2018, Banka e Shqipërisë aprovoi paraprkisht bashkimin ligjor të dy entiteteve Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka NBG Albania sh.a., duke përcaktuar si entitet mbijetues Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. Bashkimi ligjor i dy entiteteve u finalizua më 1 tetor 2018.

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 dhjetor 2006. Banka është e licencuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 dhjetor 2024, kapitali i regjistruar aksionar ishte 3,450,935 mijë Lekë (31 dhjetor 2023: 3,450,935 mijë Lekë i përbërë nga 84,769 aksione me vlerë nominale prej 295.59 Euro (ekuivalente në Lekë 40.709,87 Lekë).

Zyra Qendrore e Bankës është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 27 degësh më 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 21 degë).

Banka zotëron 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “ABI Invest sh.a.” dhe “ABI Broker sh.a.” të cilat operojnë përkatësisht në tregun e investimeve dhe atë të sigurimeve, të regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më 22.12.2020 dhe 10.01.2019.

Banka ka 436 të punësuar më 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 375), nga të cilët 249 (31 dhjetor 2023: 232) janë të punësuar në Zyrën Qendrore.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata për përputhshmërinës rregullative

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë të miratuara nga Drejtimi i Bankës më datë 18 mars 2024. Banka ka aplikuar përjashtimin për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, duke qenë se Shoqëria “Tranzit sh.p.k.” përgatit pasqyrat e konsoliduara për të gjithë grupin. Shih shënimin 4 b).

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(b) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që Banka do të vazhdojë aktivitetin e saj për një periudhë prej të paktën 12 muaj nga data e raportimit financiar. Sipas politikave të brendshme dhe atyre rregullatore, banka është e detyruar të kryejë provat e rezistencës sipas skenarëve, me qëllim përlogaritjen e likuiditetit të nevojshëm dhe normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në kushtet e skenarëve të përkeqësuar të tregut për të vlerësuar më tej nevojën e implementimit të planeve të rikuperimit apo marrjen e masave paraprake të menaxhimit e likuiditeteve. Këto teste stresi përfshijnë: testin vjetor të stresit të likuiditetit, testin e stresit të rrezikut të kredisë, vlerësimin e brendshëm të likuiditetit (ILAAP), planin e rimëkëmbjes, planin e zgjidhjes, etj.

Njëkohëshish, Banka synon të testojë ndikimin e mundshëm të treguesve makroekonomikë në pozicionin financiar, performancën dhe pajtueshmërinë rregullatore, përmes buxhetimit dhe planeve afatmesme, duke përfshirë vlerësimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, kërkesave makroekonomike, pozicioneve të hapura valutore, etj. Këto ushtrime janë ndërtuar mbi modelet e sugjeruara të Bankës së Shqipërisë si dhe modeleve të brendshme të ngritura në përputhje me profilet e rrezikut të ndërmarrë dhe përqendrimit të portofoleve të kredisë, depozitave dhe investimeve. Në secilin skenar, Banka parashikon mbulimin e nevojave të likuiditetit përmes instrumenteve financiare, huave ndërbankare, brenda një periudhe afatshkurtër prej 3 muajsh nga data e zbatimit të skenarit përkeqësues.

Nën ndikimin e skenarëve të stresuar si rezultat i rritjes së rrezikut të kredisë dhe rrezikut të tregut, Banka raportoi për fundin e vitit një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas ICAAP prej 12.96% kundrejt minimumit prej 12%. Norma faktike e mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit ishte 18.2%, mbi minimumin e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, duke siguruar suficit të kënaqshëm kapitali dhe tavani kreditor. Parametrat e kapitalit mbështetën në mënyrë të kënaqshme aktivitetin e biznesit gjatë vitit 2024, me një rritje të raportuar të huave bruto prej +26% (në bazë vjetore) dhe të depozitave të klientëve prej +15% (në bazë vjetore), duke tejkaluar gjithashtu shifrat e buxhetuara

Nën ndikimin e skenarëve të stresuar si rezultat i rritjes së rrezikut të kredisë dhe rrezikut të tregut, Banka raportoi për fundin e vitit një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas ICAAP prej 12.96% kundrejt minimumit prej 12%. Norma faktike e mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit ishte 18.2%, mbi minimumin e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, duke siguruar suficit të kënaqshëm kapitali dhe tavani kreditor. Parametrat e kapitalit mbështetën në mënyrë të kënaqshme aktivitetin e biznesit gjatë vitit 2024, me një rritje të raportuar të huave bruto prej +26% (në bazë vjetore) dhe të depozitave të klientëve prej +15% (në bazë vjetore), duke tejkaluar gjithashtu shifrat e buxhetuara. Bazuar në faktorët e mësipërm, Menaxhmenti i Bankës ka arsye të mjaftueshme për të vlerësuar aftësinë e saj për të ndjekur aktivitetin në përputhje me parimin e vijimësisë së veprimtarisë dhe konstaton se nuk ka tregues apo pasiguri që mund të vënë në dyshim aftësinë e Bankës për të vazhduar si një entitet në vijimësi.

(c) Çështjet që lidhen me klimën

Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, nuk është identifikuar asnjë rrezik që mund të ndikojë në aktivitetin e Bankës. Menaxhmenti i Bankës vlerëson se në të ardhmen mund të ketë ndryshime potenciale në kuadrin ligjor të lidhura me çështjet klimatike dhe mjedisore; megjithatë, Banka është e përgatitur mirë për të parandaluar dhe zbutur çdo rrezik që mund të ndikojë në aktivitetin e saj. Aktualisht, Banka e konsideron ndikimin e këtyre rreziqeve pothuajse zero, ndërkohë që politika e saj e kredisë mbetet e kujdesshme në drejtim të mbështetjes së çështjeve klimatike, mjedisore dhe të përgjegjësisë shoqërore. Në përputhje me vitin e kaluar, më 31 dhjetor 2024, Banka nuk ka identifikuar rreziqe të rëndësishme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike që mund të ndikojnë negativisht dhe materialisht në pasqyrat financiare të Bankës. Supozimet mund të ndryshojnë në të ardhmen në përgjigje të rregulloreve të ardhshme mjedisore dhe rregullatore dhe angazhimeve të reja të marra. Këto ndryshime, nëse nuk parashikohen, mund të kenë ndikim në flukset e ardhshme të parasë, performancën financiare dhe pozicionin financiar të bankave.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(d) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të instrumenteve të borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse, të cilat maten me vlerë të drejtë, aktivet e mbajtura për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë minus koston për ti shitur, dhe inventarit, i cili matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

(e) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Këto pasqyra financiare të veçanta të Bankës janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Gjithë informacioni i paraqitur në Lekë është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur është shprehur ndryshe.

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL

3.1 Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara

Disa standarde të kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2024 dhe që kanë qenë të miratuara, nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Bankës. Për këtë arsye, informacioni shpjegues në lidhje me këto standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Bankës.

Standarde, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që janë efektive për herë të parë në vitin 2024 dhe që mund të aplikohen në Bankë janë:

- Klasifikimi i Detyrimeve Afatshkurtra ose Afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i Qirasë në një Shitje dhe Marrje më pas me Qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet Financiare të Furnitorët (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese (Ndryshimet në SNK 1)

3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Banka

Disa standarde dhe amendime që ende nuk janë efektive dhe që nuk janë adoptuar më herët nga Banka përfshijnë:

- Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese'

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare gjatë periudhës së aplikimit fillestar, dhe, prandaj, nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, por ende joefektive, disa ndryshime dhe shtesa në Standardet ekzistuese, si dhe disa Interpretime, janë publikuar nga IASB ose IFRIC. Asnjë nga këto standarde ose ndryshime në standardet ekzistuese nuk janë adoptuar më herët nga Banka dhe nuk janë lëshuar Interpretime që janë të aplikueshme apo që duhet të merren në konsideratë nga Banka në datën e raportimit.

Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet e rëndësishme do të adoptohen për herë të parë për periudhën që fillon në ose pas datës efektive të njoftimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

Kombinimet e biznesit

Banka zbaton metodën e blerjes në kombinim e biznesit. Detyrimi i transferuar nga Banka për të marrë kontrollin e një filiali të kontrolluar llogaritet si shuma e vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara, detyrimeve të kryera dhe interesave të kapitalit datën e blerjes së pasurive të transferuara, pasiveve të lindura dhe interesave të kapitalit neto lëshuar nga Banka, e neto të emetuara nga Banka, ku përfshihet vlera e drejtë e cdo aktivi ose pasivi që rrjedh nga një marrëveshje kontigjente. Kostot e blerjes njihen mbi baze konstatimi. Aktivet e blera dhe pasivet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë të datës së blerjes.

a) Filiali dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të. Filialet mbahen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Banka nuk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi Mëma, Tranzit sh.p.k përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Informacioni mbi interesin për subjektet e tjera paraqitet në Shënimin 17.

b) Investime në pjesëmarrje

Investimi në një pjesëmarrje është një entitet mbi të cilin Banka ka ndikim pozitivisht. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët mbi këto politika.

Konsideratat e bëra në përcaktimin e ndikimit të rëndësishëm ose të kontrollit të përbashkët janë të ngjashme me ato të domosdoshme për të përcaktuar kontrollin mbi filialet. Investimi i Bankës në shoqërinë e tij llogaritet me kosto. Investimi kontabilizohet.

Pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen, Banka mat dhe njeh çdo investim të mbartur në vlerën e tij të drejtë. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të pjesëmarrjes pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm dhe vlerës së drejtë të investimit të mbartur dhe të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit njihen në fitim ose humbje.

c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitim ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë të matura me vlerë të drejtë në monedhë të huaj, këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të matura me kosto historike këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit njihen përgjithësisht në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura për këmbimin e balancave në monedhë të huaj për vitin 2024 dhe 2023 janë si më poshtë (në Lekë):

|       | 31 dhjetor 2024 | 31 dhjetor 2023 |
|-------|-----------------|-----------------|
| 1 USD | 94.26           | 93.94           |
| 1 EUR | 98.15           | 103.88          |
| 1 GBP | 118.16          | 119.47          |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

c) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Ndërsa kurset mesatare vjetore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 të konvertuar në Lekë janë si më poshtë:

|       | Viti 2024 | Viti 2023 |
|-------|-----------|-----------|
| 1 USD | 93.04     | 100.62    |
| 1 EUR | 100.70    | 108.75    |
| 1 GBP | 118.69    | 124.99    |

d) Interesat

Norma efektive e interesit

Të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (“NEI”) për të gjithë instrumentet financiare të matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare të dizenuar më Vlerë të Drejtë në fitim humbje (“VDFH”). Të ardhurat nga interesi për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (“VDATGJ”), klasifikohen si të vlefshme për shitje ose mbajtur deri në maturim, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohen egzaktesisht pagesat e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshtatshme, për periudhën më të shkurtër, duke arritur në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktivi) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njeh të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njeh efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në faza të ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjokat dhe komisionet).

Nëse pritjet në lidhje me flukset e parave në aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera nga rreziku i kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv ose negativ i vlerës kontabël të aktivit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar me një rritje ose ulje të interesit të ardhura.

Rregullimi amortizohet në vijim nëpërmjet të ardhurave nga operacionet bankare në pasqyrën e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Interesat dhe të ardhura të ngjashme

Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar NEI mbi vlerën bruto të aktivit financiar, që nuk janë aktive të zhvlerësuar. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si “Faza 3”, Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar përmirësohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivet financiare të blera apo të krijuara të zhvlerësuar (“POCI”) (siç shpjegohet në shënimin 4.j), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe më pas duke e aplikuar atë norme mbi koston e amortizuar të aktivit.

NEI i rregulluar është norma e interesit, e cila në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivit POCI.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Tarifat dhe komisioni - Të ardhurat nga shërbimet bankare të klientët

Banka fiton të ardhura nga tarifa dhe komisioni nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Tarifat dhe të ardhurat nga komisioni dhe shpenzimet që janë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Tarifat e shërbimit dhe komisionet për të cilat Banka merr përsipër një detyrim të performancës ndaj klientëve, njihen si të hyra bankare dhe llogariten sipas SNRF 15 Të ardhurat nga kontrata me klientët. Termat dhe kushtet e shërbimit të Bankës (kontratat) zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, të përfshira nën një konsideratë, rrjedhimisht nuk ka ndonjë gjykim të rëndësishëm për shpërndarjen e çmimit të transaksionit.

Për më tepër, shërbimet bankare të ofruara nga banka kanë një kohëzgjatje jo më shumë se një vit ose rinovohen në bazë vjetore (për shembull, mirëmbajtja e llogarisë). Rrjedhimisht, Banka ka përdorur një shfrytëzues praktik të standardit dhe nuk ka nevojë të paraqesë informacione për shumën e përgjithshme të çmimit, në lidhje me pjesën e pakënaqur të detyrimeve të performancës.

Kënaqësia e detyrimeve të performancës kryhet ose në një pikë të kohës kur me të ardhurat nga komisioni njihet kur shërbimi është ekzekutuar dhe transferuar të klienti, ose me kalimin e kohës kur nga Banka kryen shërbimin për një periudhë të dakordësuar dhe klienti e konsumon atë si shërbimi është duke u kryer, dhe të ardhurat njihen gjatë periudhës në fjalë..

Të ardhurat nga komisionet mund të ndahen në tre kategoritë e mëposhtme:

- Të ardhurat nga komisionet të fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë periudhës

Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhës njihen gjatë kësaj kohe. Këto komisione përfshijnë komisione për mirëmbajtje llogarie, kartë dhe shërbim E-banking.

- Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve në një kohë të caktuar

Këtu përfshihen Të ardhurat nga komisioni të njohura në një kohë të caktuar zakonisht kanë të bëjnë me transaksionin. Ato përfshijnë tarifa nga porositë e pagesës dhe transferimit të klientëve, dhe shërbimet e tjera bankare të ofruara. Tarifat e shërbimeve të huasë që nuk janë pjesë e normës efektive të interesit, përfshirë komisionet e sigurimeve, njihen gjithashtu kur shërbimi kryhet dhe transferohet të klienti. Këto tarifa ose përbërës të tarifave që janë të lidhura me një performancë të caktuar dhe njihen si shërbime të lidhura.

Tarifat e tjera dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin në shërbimet financiare të operuara nga Banka dhe njihen kur shërbimi përkatës sigurohet ose pranohet.

f) Shpenzimet tatimore

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë, që njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes së periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme për të ardhurat e tatueshme ose për shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësuesi më i mirë i shpenzimit të pritshëm taksativ për t'u paguar ose arkëtuar që reflekton pasiguri lidhur me tatim fitimin, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Shpenzimet tatimore (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme. Aktivët tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren.

Aktivët tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është i mundur realizimi i përfitimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet. Aktivët tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyre llogaritet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

(iii) Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Banka merr në konsideratë efektin e situatave të pasigurta nga ku mund të lindin detyrime shtesë në lidhje me taksat. Ky vlerësim bazohet në supozime dhe parashikime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të së ardhmes. Informacione të reja të mundshme mund të bëjnë Bankën të ndryshojë gjykimin e saj përsa i përket saktësisë së detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të mundshme në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin për tatimin në periudhën në të cilën ky konstatim do të bëhej.

g) Instrumentet financiare – njohja fillestare

(i) Data e njohjes

Banka njeh fillimisht huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve, depozitat, letrat me vlerë të emetuar dhe detyrimet e varura në datën në të cilën janë origjinar. Blerjet e zakonshme dhe shitja e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blere apo shitur aktivin. Të gjithë aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njeh detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar në Bankë.

(ii) Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (“VDFH”), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme maten me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, siç përshkruhet më poshtë.

## BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

### Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(iii) *Fitimi ose humbja e Ditës së parë*

Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njeh diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

(iv) *Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare*

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve të matura me:

- koston e amortizuar
- VDATGJ
- 

#### h) Aktive dhe detyrime financiare

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huave dhe garancive financiare, maten me kosto të amortizuar ose me VDFH kur mbahen për tregtim ose përcaktimi i vlerës së drejtë është i aplikueshëm. Shpjeguar në politikën kontabël 4.g.

#### **Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët dhe investimet financiare me kosto të amortizuar**

Banka vlerëson huatë dhe paradhëniet për bankat, klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuar nëqoftëse të dy kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Aktivet financiare mbahen me një modeli biznesi me qëllimin për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuar flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesat për shumën e papaguar të tij.

Detajet e këtyre kushteve përshkruhen më poshtë.

#### *Përcaktimi i modelit të biznesit*

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në portofole të grupuara. Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët në "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

#### *Testi SPPI*

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. "Principalit" për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos). Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevante si monedha në të cilën është shprehur aktiviteti financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

## BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

### Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

#### h) Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqëndrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kane lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricën e huasë. Në raste të tilla, aktiviteti financiar duhet të matet në VDFH.

#### **Instrumentet e borxhit në VDATGJ**

Banka i vlerëson investimet e tjera financiare në VDATGJ nëse të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Instrumenti i mbajtur brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet duke mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përmbushin testin SPPIs

Instrumentet e borxhit në VDATGJ janë matur më pas me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit të vlerës së drejtë të njohur në ATGJ. Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja HKP për instrumentet e borxhit shpjegohet në shënimin 4.d Kur Banka mban më shumë se një investim në të njëjtën siguri, ato konsiderohen të disponueshme në bazën hyrje e parë dalje e parë. Nga çregjistrimi, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

#### **Instrumentet e kapitalit në VDATGJ**

Pas njohjes fillestare, Banka zgjedh herë pas here të klasifikojë në mënyrë të pakthyeshme disa nga investimet e saj të kapitalit si instrumente të kapitalit në VDATGJ, kur ato plotësojnë përkufizimin e përcaktimit të kapitalit sipas *SNK 32 Instrumentet Financiare: Prezantimi* dhe nuk mbahen për tregtim. Një klasifikim i tillë përcaktohet mbi bazën instrument pas instrumenti.

Fitimet dhe humbjet nga këto instrumente të kapitalit nuk riciklohen kurrë në fitim. Dividendët njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative kur është vendosur e drejta e pagesës, përveçse kur Banka përfiton nga të ardhurat e tilla si rikuperimi i një pjese të kostos së instrumentit, në këtë rast, fitimet e tilla regjistrohen në ATGJ. Instrumentet e kapitalit në VDATGJ nuk i nënshtrohen një vlerësimi për zhvlerësimin.

Banka nuk ka ndonjë instrument të tillë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

#### **Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe angazhimet e huave të pashfrytëzuara**

Banka lëshon garanci financiare, letra krediti dhe angazhimet të huave.

Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare të veçanta si zëra jashtë bilancit dhe janë paraqitur në angazhimet dhe eventualitetet me vlerën e drejtë, duke qenë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën secilën garanci matet më të lartën mes shumës së njohur fillimisht duke zbritur amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe - një provizion HKP siç përcaktohet në Shënimin 4.j.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në Të ardhurat neto nga komisionet me metodën lineare përgjatë jetës së garancisë.

Angazhimet e huave të pashfrytëzuara janë angazhime për të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohet t'i sigurojë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Kontratat e garancisë financiare janë në fushën e kërkesave të HKP-së.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

h) Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)

Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe angazhimet e huave të pashfrytëzuara (vazhdim)

Vlerat nominale kontraktuale të garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të huave të pashfrytëzuara, ku kredia për të cilën është rënë dakord është me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlerat nominale të këtyre instrumenteve bashkë me HKP-të përkatëse janë paraqitur në Shënimin 12.

i) Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka nuk riklasifikon aktivet e saj financiare përtej njohjes së tyre fillestare, përveç situatave të jashtëzakonshme të përmendura në Standard.

Gjatë vitit 2020, Banka identifikoi që një pjesë e instrumenteve financiare të përfituara nga bashkimi me ish-NBG, mbajtën klasifikimin e tyre të mëparshëm si VDATGJ në vend që të klasifikoheshin në përputhje me politikën e Bankës.

j) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Çregjistrime nga modifikimet thelbësore të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një aktiv financiar, të tillë si huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes së HKP-ve, përveçse kur kredia e re, konsiderohet të jetë POCl. Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestar, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën e paregjistruar të humbjes nga zhvlerësimi.

Për detyrimet financiare, Banka konsideron një modifikim si të konsiderueshëm bazuar në faktorët kualitativë dhe nëse rezulton në një diferencë ndërmjet vlerës aktuale të skontuar të rregulluar dhe vlerës kontabël të detyrimit financiar prej dhjetë përqind ose më shumë. Për aktivet financiare, vlerësimi bazohet në faktorë cilësorë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

j) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar si dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ("përfituesit eventuale"), kur të tre kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventuale, përveç nëse ka arkëtuar shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut.
- Banka nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventuale.
- Banka duhet të dorëzojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventuale pa vonesë materiale. Gjithashtu, Banka nuk ka të drejtë të ri-investojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventuale.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njeh edhe një detyrim lidhur me të. Aktivët e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të konsideratës që Bankës mund t'i kërkohej të paguajë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

j) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore (vazhdim)

Aktivet financiare (vazhdim)

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsiioni të shkruar ose të blere (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Bankës t'i kërkohej të paguajë gjatë riblerjes. Në rastin e një kontrate me opsiion të shkruar mbi një aktiv që matet me vlerë të drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e limituar më të voglën e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opsiionit.

Detyrime financiare

Një detyrimi financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë thelbësore, zëvendësimi ose modifikim i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

k) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP

Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.

Fondi i zhvlerësimit HKP bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose AGJHKP), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritur të kredisë në 12 muaj (12mHKP).

Politikat e Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënimin 12.

HKP 12-mujore është pjesa e AGJHKPs që përfaqëson HKP që rezulton nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Të dy AGJHKP dhe 12mHKP janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku i kredisë i nëse instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grumbullon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeh një zhvlerësim në bazë të 12mHKP. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për AGJHKP-te. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP (vazhdim)

- Faza 3: kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara plotësisht. Banka regjistron një fond për AGJHKP
- POCl: Aktivet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuara ("POCl") janë aktivet financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Aktivet POCl regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HKP-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë. Aktivet e zhvlerësuara të kredisë të fituara në një kombinim biznesi nuk trajtohen si POCl.

Për aktivet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjese të saj, vlera kontabël bruto e aktivit financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivit financiar.

Përlllogaritja e HKP-ve

Banka llogarit HKP-të në bazë të tre skenarëve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mungesat e flukseve të pritshme të arkëtimeve, të skontuara në një përafrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësia ekonomike pret të arkëtojë.

Mënyra e llogaritjeve HKP është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PD – Mundësia e dështimit ("PD") është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është çregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndroje në portofolin e Bankës.
- EAD – Ekspozimi në Dështim ("EAD") është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluara në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesat nga pagesat e pakryera.
- LGD – Dështimi në humbje ("LGD") është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që huadhënësi pret të arkëtojë.

Për llogaritjen e HKP-ve, Banka konsideron tre skenarë (bazë, optimist dhe pesimist).

Secila prej tyre shoqërohet me PD të ndryshme. Kur është e rëndësishme, vlerësimi i skenarëve të shumtë përfshin gjithashtu se si pritet të rikuperohen huatë e papaguara, duke përfshirë dhe mundësinë që huatë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose shuma mund të merret nga shitja e aktivit.

Periudha maksimale për të cilën përcaktohen humbjet e kredisë është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore ta quajë atë më herët. Humbjet dhe lëshimet nga zhvlerësimi llogariten dhe shpalosen veçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (VAZHDIM)

k) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Përlllogaritja e HKP-ve (vazhdim)

Mekanika e metodës HKP është përmbledhur më poshtë:

- Faza 1:* 12m HKP llogaritet si pjesë e AGJHKP-ve që përfaqësojnë HKP-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit fondin e 12m HKP bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme dhe të skontuar me një NEI të përafërsuar me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç është shpjeguar më sipër.
- Faza 2:* Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Banka regjistron një fond për AGJHKP. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumtë, por PD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me një përafërsim të NEI-t origjinal.
- Faza 3:* Për kreditë që konsiderohen si të zhvlerësuara, Banka njih humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për këto kredi me llogaritje zhvlerësimi individual. Si parim, shuma e provizionit e kredive që zhvlerësohen në baza individuale llogaritet si diferenca ndërmjet shumës së mbetur papaguar të kredisë me a) shumën e kolateralit likuid dhe me b) shumën e vlerës aktuale të të gjitha flukseve monetare të ndryshme të zbritura me normën aktuale të interesit të kredisë;
- Aktivet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Banka njih vetëm ndryshimet kumulative AGJHKPs që nga njohja fillestare, bazuar në tre skenarë me probabilitete, skontuar nga NEI i rregulluar.

Angazhimet e huave, letrat e kreditit dhe garancitë financiare:

Faktori i konvertimit të kredisë përdoret për të kthyer shumën e një linje krediti (pjesa e papërdorur) dhe shuma të tjera jashtë bilancit në një shumë të EAD. Është një supozim i modeluar, i cili përfaqëson një pjesë të çdo ekspozimi të papërdorur që pritet të tërhiqet para se të ndodhë një ngjarje e paracaktuar. Për secilin lloj produkti, faktori CCF për Bankën zbatohet si më poshtë:

- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur <= 1 vit = 20%
- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur > 1 vit = 50%
- Pjesa e papërdorur e kredive me afat = 0%
- Pjesa e papërdorur e overdrafteve = 20%
- Pjesa e papërdorur e kartave të kreditit = 20%

Instrumente të borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet ATGJ

HKP-ja për instrumente të borxhit të matura në VDATGJ nuk e zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet me vlerën e drejtë. Përkundrazi, një shumë e njëjtë me fondin, që do të krijohet nëse aktivet që maten me koston e amortizuar, njihet në ATGJ si një shumë zhvlerësimi e akumuluar, me një ngarkimin përkatës në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ do të riciklohet në fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit të aktivit.

Aktive financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara (POCI)

Për aktivet financiare POCI, Banka njih vetëm ndryshimet kumulative në AGJHKP që nga njohja fillestare në fondin e humbjeve.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Informacion për ndodhi që priten të ndodhin

Në modelet e saj HKP, Banka mbështetet në një gamë të gjerë informatash të ardhshme, si inpute ekonomike, si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto ("PBB")
- Normat e papunësisë
- Normat bazë të Bankës Qendrore
- Normat e inflacionit

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HKP-ve nuk mund të kapin gjithnjë karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për të pasqyruar këtë, rregullime cilësore bëhen herë pas here si rregullime të përkohshme kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale.

I) Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateraleve dhe garancitë financiare

Për të zvogëluar rrezikun e kredisë mbi aktivet financiare, Banka kërkon të përdorë kolaterale, kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme, të tilla si para, letra me vlerë, letra krediti / garanci, pasuri të paluajtshme, arkëtime, inventarë dhe aktive të tjera jo-financiare. Kolaterali, përveç nëse merret në pronësi, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

Sidoqoftë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e HKP-ve. Në përgjithësi vlerësohet, në minimum, në fillim dhe rivlerësohet në baza të shpeshta [periudha të ndryshme për lloje të ndryshme: Për shembull për kolaterale pasuri të paluajtshme, frekuenca është vjetore (ambiente biznesi) ose çdo 3 vjet (ambiente banimi)] . Sidoqoftë, disa kolaterale, për shembull, para ose letra me vlerë që kanë të bëjnë me kërkesat e marxhinalizimit, vlerësohen çdo ditë.

Me aq sa është e mundshme, Banka përdor të dhëna të tregut aktiv për vlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera financiare që nuk kanë vlera të tregut të përcaktueshme lehtësisht, vlerësohen duke përdorur modele. Kolaterali jo financiar, siç është pasuria e paluajtshme, vlerësohet bazuar në të dhënat e paraqitura nga palët e treta siç janë vlerësuesit e brendshëm / të jashtëm të pasurive.

Nëse një kredi, si pjesë e kushteve të saj kontraktuale, është e garantuar nga një palë e tretë, Banka vlerëson HKP përkatëse bazuar në rrezikun e kombinuar të kredisë së garantuesit dhe palës së garantuar, duke reflektuar garancinë në matjen e humbjes në rast dështimi (LGD). Banka e konsideron garancinë financiare si përbërëse të kushteve kontraktuale të kredisë së garantuar, kur garancia është bere në të njëjtën kohë, ose brenda një kohë të shkurtër, pas avancimit të kredisë.

Garancitë që nuk janë parësore për kushtet e kontratës së kredisë, llogariten si njësi e veçantë e llogarive që i që janë subjekt i HKP-së.

m) Inventari (aktive të marra në zotërim)

Politika e Bankës përcakton nëse një aktiv i marrë në zotërim mund të përdoret për operacionet e brendshme ose duhet shitur. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brendshme transferohen në kategorinë përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët midis vlerës së marrjes në pronësi ose vlerës kontabël të aktivit origjinal. Aktivet për të cilat shitja përcaktohet të jetë një opsion më i mirë transferohen në aktivet e mbajtura për shitje me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë aktive financiare) dhe vlerën e drejtë pakësuar me koston për të shitur për aktivet jo-financiare në datën e rimarrjes, në përputhje me politikën e Bankës

Në rrjedhën e saj normale të biznesit, Banka angazhon agjentë të jashtëm për të rikuperuar fonde nga aktivet e rivlerësuar, përgjithësisht në ankand, për të shlyer borxhin e mbetur. Çdo fond i tepërt u kthehet klientëve / debitorëve. Si rezultat i kësaj praktike, pronat e banimit në proceset e riblerjes ligjore nuk janë regjistruar në bilanc.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

n) Fshirjet

Aktivët financiarë fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësi ose një pjesë të tij. Nëse shumat që duhet të fshihen është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi, i cili më pas aplikohet ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rimarrje pasuese kreditohet të shpenzimi i humbjeve të kredisë.

o) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara

Banka ndonjëherë bën lëshime ose modifikime të kushteve origjinale të kredisë si përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend që të marrë në pronësi ose të zbatojë ndryshe mbledhjen e kolateralit.

Banka e konsideron një kredi të ristrukturuar kur lëshime të tilla ose modifikime janë dhënë si rezultat i vështirësive financiare aktuale ose të pritura të huamarrësit dhe Banka nuk do i kishte pranuar nëse huamarrësi do të ishte i shëndetshëm financiarisht. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë dështim në kovenantë ose shqetësimet e rëndësishme të ngritura nga Njësia e Menaxhimit të Riskut të Kredisë.

Ristrukturimi mund të përfshijë zgjerimin e marrëveshjeve të pagesës dhe marrëveshjen me kushtet e reja të kredisë. Pasi termat janë rinegociuar, çdo zhvlerësim matet duke përdorur NEI-n origjinal siç është llogaritur para modifikimit të termave. Është politikë e Bankës monitorimi i kredive të ristrukturuara për të siguruar që pagesat në të ardhmen të vazhdojnë të ndodhin.

Vendimet e çregjistrimit dhe klasifikimi midis Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen në bazë të kritereve të paracaktuara. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një kredi, ajo shpaloset dhe menaxhohet si një aktiv i zhvlerësuar i Fazës 3 derisa të arkëtohet, periudha e provës të përfundojë me sukses, ose të shlyhet.

Kur kredia është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka rivlerëson gjithashtu nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë. Banka konsideron nëse aktivet duhet të klasifikohen si Faza 3.

Sapo një aktiv të jetë klasifikuar si i ristrukturuar, ai do të mbetet i ristrukturuar për një periudhë minimale provë 12-mujore. Në mënyrë që huaja të riklasifikohet nga kategoria e ristrukturimeve, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha ekspozimet e tij konsiderohen si performuese
- Periudha e provës prej një viti ka kaluar që nga data që kontrata e ristrukturimit konsiderohej si performuese.
- Klienti nuk ka më kontrata që kanë më shumë se 30 ditë vonesa.

p) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut (p.sh. një çmim dalje) pavarësisht nëse ai çmim është direkte i vëzhgueshme ose i vlerësueshëm duke përdorur metodë tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të llogariten nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash vlerësimi që përfshijnë dhe përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele merren nga tregjet të vëzhgueshme ku është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, vlerësimi kërkohet në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsiderime për likuiditetin dhe inpute të modeleve të lidhura me zëra si rreziku i kredisë (si i veti ashtu dhe i palëve), rregullimet e vlerës së financimit, korrelacionin dhe paqëndrueshmërinë. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 11.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

q) Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

r) Marrëveshjet e blerjes dhe të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura nën një marrëveshje për t'u ri-blerë në një datë specifike në të ardhmen nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar ndërsa Banka mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Paratë përkatëse të marra njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me detyrimin përkatës për kthimin e tyre, përfshirë interesin e përlllogaritur si një detyrim brenda kolateralit të parave mbi letrat me vlera të lëna dhe marrëveshjet e riblerjes, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi ndaj Bankës.

Diferenca midis çmimeve të shitjes dhe riblerjes trajtohet si shpenzim i interesit dhe përlllogaritet gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI. Kur kundër pala ka të drejtë të shesë ose të rivendosë letrat me vlerë, Banka i riklasifikon ato letra me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar si letra me vlerë të mbajtura për tregtim të vena si kolateral ose si investime financiare VDATGJ të vena si kolateral, siç është e përshtatshme.

Në të kundërt, letrat me vlerë të blera të lidhura me marrëveshjen për t'u shitur në një datë të caktuar të ardhshme nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Shuma e paguar, përfshirë interesin e përlllogaritur, regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar, brenda kolateralit të parave të gatshme për letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e riblerjes të anasjellta, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi nga Banka. Diferenca midis çmimeve të blerjes dhe rishitjes regjistrohet në të ardhurat neto nga interesi dhe është përlllogaritur gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI.

Nëse letrat me vlerë, të blera në bazë të një marrëveshjeje për t'u rishitur, i shiten më pas një pale të tretë, detyrimi për kthimin e letrave me vlerë regjistrohet si një shitje e shkurtër brenda detyrimeve financiare të mbajtura për tregtim dhe matet me vlerën e drejtë me çdo fitim ose humbje të përfshirë në të ardhurat neto nga tregtimi.

s) SNRF 16 Qiratë Financiare

(i) Banka si qiramarrës

Banka nënshkruan marrëveshje qiraje, kryesisht për ambientet ku zhvillohet aktiviteti, pajisjet dhe mobilitet e lidhura me to, pajisjeve IT dhe automjeteve motorike (megjithëse aktualisht Banka nuk përdor automjete me qira).

Kontratat e qirasë negociohen zakonisht për një kohëzgjatje ndërmjet 1 dhe 5 vjetëve dhe disa prej tyre kanë opsionin e zgjatjes së kohëzgjatjes së kontratës. Banka nuk hyn në marrëveshje të shitjes dhe kthimit të objekteve të marra me qira. Të gjitha qiratë janë negociuar mbi baza individuale dhe përmbajnë një larmi të gjerë të termave dhe kushteve të tilla si; termat e pagesës, mbylljes së kontratës dhe klauzolat e përshkallëzimit.

Banka vlerëson nëse ekziston një kontratë qiraje apo nëse një kontratë aktive përmban një qira në përbërjen e saj. Një qira përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv dhe për të marrë të gjitha përfitimet ekonomike të këtij aktivi për një periudhë të caktuar kohore, në këmbim të vlerësimit. Disa kontrata qiraje mund të përmbajnë komponentë qiraje ashtu dhe jo qiraje. Këto komponentë jo të lidhura me qiranë, zakonisht lidhen me shërbimet e menaxhimit të pajisjeve të zyrës si edhe kontratat e servisit dhe riparimit të automjeteve motorike. Banka ka zgjedhur të mos i ndajë komponentët e një kontratë qiraje por këto kontrata llogariten si një komponent i vetëm i qiramarrjes. Për qiratë e tjera të saj, përbërësit e qirasë ndahen në komponentët e qirasë dhe jo të qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

s) SNRF 16 Qiratë Financiare (vazhdim)

(i) Banka si qiramarrës (vazhdim)

Matja dhe njohja e qirave nga qiramarrësi

Në datën e fillimit të qirasë, Banka njih një të drejtë përdorimi të aktivitet dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktivitet matet me kosto, i cili përbëhet nga: matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga Banka, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të kohëzgjatjes së qirasë dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo pagesë/zbritje e marrë)

Banka zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivitet mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivitet. Banka gjithashtu vlerëson të drejtën e përdorimit të aktivitet për qëllime të zhvlerësimit, kur tregues të tillë ekzistojnë.

Në datën e fillimit, Banka mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të zbritura duke përdorur normën e borxhit të Bankës ose normën mesatare të tregut të qiradhënies. Norma e borxhit është norma e vlerësuar që Banka do të duhej të paguante për të marrë hua të njëjtën shumë për një njëjtin afat, për të përfituar një aktiv me një vlerë ekuivalente me atë të marrë me qira. Kjo normë rregullohet nëse njësia ekonomike e qiradhënësit ka një profili rreziku të ndryshëm në krahasim me atë të Bankës.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse, pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shumat që priten të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që dalin nga opsionet të arsyeshme dhe të sigurta për t'u ushtruar.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që janë alokuar ndërmjet ripagimeve të principalit dhe shpenzimeve financiare. Shpenzimet financiare përfaqësojnë shumat që prodhojnë një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë. Këto ndryshime vijnë nga një ndryshim në afatin e qirasë ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë një aktiv me qira. Pagesat e rishikuara të qirasë zbriten duke përdorur normën e borxhit të Bankës në datën e rivlerësimit, kur norma e nënkuptuar në qira nuk është e mundur të përcaktohet. Shuma e rimatjes së detyrimit të qirasë pasqyrohet si rregullim i vlerës kontabël të së drejtës së përdorimit të aktivitet. Përfshirje është kur vlera kontabël neto e së drejtës së përdorimit është reduktuar në zero dhe çdo tepriçë njihet në fitim ose humbje.

Pagesat nën qira mund të ndryshojnë gjithashtu kur ka ose një ndryshim në shumat që priten të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur ose kur pagesat e ardhshme ndryshojnë përmes një indeksi ose normë të përdorur për të përcaktuar ato pagesa, përfshirë ndryshimet në normat e qirasë në treg pas një rishikimi të tregut të qirasë. Detyrimi i qirasë rimatet vetëm kur rregullimi i pagesave të qirasë ka efekt dhe pagesat e rishikuara kontraktuale për pjesën e mbetur të afatit të qirasë zbriten, përdorur një normë skontimi të pandryshuar. Përfshirje rastet kur ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton nga ndryshimi i normave të interesit të ndryshueshme, rast në të cilin norma e skontimit ndryshohet për të pasqyruar dhe ndryshimin në normat e interesit.

Për t'u përgjigjur nevojave të biznesit veçanërisht në kërkesën për hapësirë për zyra, Banka do të hyjë në të negociata me pronarët për të rritur ose ulur hapësirën e disponueshme për zyra ose për të rinegociuar shumat e pagueshme sipas qirave përkatëse. Në disa raste, Banka është në gjendje të rrisë kapacitetin e zyrës, duke marrë në dispozicion hapësira shtesë të lira dhe duke rënë dakord me qiradhënësin për të paguar një shumë që është në përpjesëtim me çmimet e secilës për të pasqyruar kushtet përkatëse të kontratës. Në këto situata, marrëveshja kontraktuale trajtohet si një qira e re dhe llogariten në përputhje me rrethanat.

Në raste të tjera, Banka është në gjendje të negociojë një ndryshim të një kontrate qiraje, si uljen e shumës së hapësirës për zyra, zvogëlimin e afatit e qirasë ose zvogëlimin e shumës totale të pagueshme për qiranë. Këto komponentë nuk ishin pjesë e kushteve origjinale të qirasë. Në këto situata, Banka nuk i konsideron këto komponentë si ndryshime, por i trajton si një kontratë e re qiraje.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

s) SNRF 16 Qiratë Financiare (vazhdim)

(i) Banka si qiramarrës (vazhdim)

Matja dhe njohja e qirave nga qiramarrësi (vazhdim)

Në vend të kësaj, pagesat e rishikuara kontraktuale skontohen duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit në datën kur qiraja modifikohet në mënyrë efektive. Për arsyet e shpjeguara më sipër, norma e skontimit është norma e borxhit të Bankës e përcaktuar në datën e modifikimit, pasi norma e nënkuptuar në qira nuk është e lehtë për t'u përcaktuar.

Ri-matja e detyrimit të qirasë sjell një zvogëlim të vlerës kontabël të aktivitet me të drejtë përdorimi, për të pasqyruar përfundimin e plotë ose të pjesshëm të qirasë për ato modifikime të saj që zvogëlojnë fushëveprimin e qirasë. Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. E drejta e përdorimit të aktivitet rivlerësohet për të pasqyruar të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Banka ka zgjedhur të aplikojë përjashtimin për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur qëllimet praktike. Këto qira kanë të bëjnë me sendet e pajisjeve të zyrës si tavolina, karrige dhe pajisje të caktuara IT. Në vend që të njohin një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje, pagesat në lidhje me këto qira njihen si një shpenzim periudhe në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Banka si qiradhënës

Si qiradhënës Banka klasifikon qiratë e tij si qira operative ose financiare. Një qira klasifikohet si një qira financiare nëse i transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi.

t) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Nëse pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërësit kryesor) të aktiveve afatgjatë materiale. Çdo fitim ose humbje nga shitja ose nxjerrja jashtë përdorimi i një aktivi afatgjatë (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivitet dhe vlerës kontabël të aktivitet) njihet të të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kosto të tjera pasuese

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivitet njihen me vlerën kontabël të aktivitet nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktiv do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme..

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen.

Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë:

|                                        | Në vite |
|----------------------------------------|---------|
| • Ndërtesa                             | 20-50   |
| • Mobilje dhe pajisje zyre             | 5       |
| • Automjete                            | 4-5     |
| • Kompjuterat dhe pajisjet elektronike | 4       |

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

t) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Aktivët nuk amortizohen deri në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve. E drejta e përdorimit të aktiveve paraqiten së bashku me pronat dhe pajisjet në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohen metodën lineare gjatë afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve.

u) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

|                                     |      |
|-------------------------------------|------|
|                                     | Vite |
| • Programe kompjuterike dhe licenca | 4    |

v) Aktivët e mbajtura për qëllime investimi

IAS 40 “Pronat e investimit” zbatohet për kontabilizimin e pasurive të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesa) të mbajtura për të gjeneruar të ardhura nga qiratë ose për rritje të vlerës së kapitalit (ose të dyja). Pronat e investimit fillimisht maten me kosto dhe, me disa përjashtime, mund të maten më pas duke përdorur modelin e koston ose modelin e vlerës së drejtë, ku ndryshimet në vlerën e drejtë sipas modelit të vlerës së drejtë njihen në fitim ose humbje.

w) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga aktivet tatimore të shtyra dhe inventarët, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabël e aktivit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron flukse monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të lidhura me njësitë që gjenerojnë flukse monetare janë njohur fillimisht për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të mirë të alokuar kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare), me bazë të ponderuar.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese së mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

x) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe rreziqe specifike ndaj detyrimit. Shpenzimet lidhur me çdo provizion prezantohen në pasqyrën e të ardhurave neto nga çdo rimbursim në shpenzime të tjera operacionale.

y) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore, të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuar. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumenteve financiare e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- a. rreziku i kredisë
- b. rreziku i likuiditetit
- c. rreziku i tregut
- d. menaxhimi i kapitalit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtuesve ka përgjegjësi për vendosjen dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC), dhe komitetin e Provizionimit, të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtuesve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut.

Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Auditit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e veta Komiteti i Auditit mbështetet nga Auditit i Brendshëm. Auditit i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe ‘ad-hoc’ politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Auditit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të borxhit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjerë jashtë bilanci. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mos përmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industrisë). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqendrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Nivelet e Delegimit dhe Procesi i Eskalimit për Miratimin e Kredive – Bordi i Drejtorëve delegon autoritetin e tij për miratimin e kredive tek Komiteti Lokal i Kredive për financime deri në ekuivalentin e 6,000,000 EUR. Në dhjetor 2024, për të rritur fleksibilitetin për klientët dhe për të përshpejtuar marrjen e vendimeve duke ruajtur njëkohësisht përputhshmërinë me parametrat e rrezikut të përcaktuar nga Banka, Bordi zgjeroi autoritetin e Komitetit Lokal të Kredive si më poshtë:

Komiteti mund të miratojë rritje ose kufij të rinj kredie që tejkalojnë 6,000,000 EUR deri në shumën më të madhe ndërmjet:

- a) 10% të kufirit ekzistues të kredisë të miratuar më parë nga Bordi, ose
- b) 1% të kapitalit të Bankës (NAS).

Ky autoritet i zgjeruar i nënshtrohet kushteve të mëposhtme: (i) Ekspozimi total i klientit ose grupit duhet të mbetet brenda kufirit të huadhënies së Bankës; (ii) Bordi duhet të njoftohet ditën pasuese të punës pas miratimit të tillë; (iii) Propozimi i plotë duhet t'i paraqitet Bordit në datën e radhës të rishikimit të planifikuar për ekspozimin e klientit/grupit, ose brenda 12 muajsh – cilado nga këto që ndodh e para. Për sektorë ose palë të kundërta me rrezik të lartë — duke përfshirë lojërat e fatit, institucionet financiare, partitë politike dhe fondacionet — autoriteti për miratimin mbetet ekskluzivisht tek Bordi, pavarësisht nga shuma e financimit.

Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori: a) standarde, b) në ndjekje, c) nën-standarde, d) e dyshimtë dhe e) e humbur. Kreditë e klasifikuara në dy kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e tre kategorive të tjera konsiderohen si kredi me probleme.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

Përveç kriterit të ditë vonesave, Banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimit të rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësitë Menaxhues
- Kolateralin dhe garantët
- Struktura e kredive

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime që përndryshe nuk do ti konsideronte. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuar individualisht në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit.

Rreziku i angazhimeve të lidhura me kredinë

Banka vë në dispozicion të klientëve garanci që mund të kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në emër të tyre dhe të hyje në angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre për likuiditet. Letrat e kreditit dhe garancitë (duke përfshirë edhe letrat e kreditit në gatishmëri) angazhojnë Bankën për të bërë pagesa në emër të klientëve në rast të një akti të veçantë, në përgjithësi lidhur me importin ose eksportin e mallrave. Këto angazhime e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme për kreditë dhe zbuten nga të njëjtat procese dhe politika të kontrollit.

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit

Banka konsideron një instrument financiar të dështuar (humbur), dhe për rrjedhojë e kategorizon si Faza 3 për të përlogaritur HKP, në të gjitha rastet kur kredi marrësi është në vonesë mbi 90 ditë për detyrimet kontraktuale të tij. Banka konsideron balancat e thesarit dhe të tregut ndër bankar të dështuara, dhe merr masa të menjëhershme, kur pagesa e pritshme nuk është ekzekutuar në ditën e caktuar sipas kontratës mes palëve. Si pjesë e vlerësimit cilësor nëse një klient është në dështim, Banka gjithashtu konsideron një varietet elementësh të cilët mund të tregojnë pamundësi pagese. Në rast të një ngjarje të tillë, Banka me kujdes konsideron nëse ngjarja mund të rezultojë në trajtimin e klientit si të dështuar, e për rrjedhojë ta kategorizojë nën Fazën 3 apo Fazën 2 si më të përshtatshmen për të përlogaritur HKP.

Ngjarje të tilla përfshijnë:

- Vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- Shkelja e një kovenanti, si mospagimi ose ngjarje me ditë vonesa;
- Huadhënësit e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale të lidhura me vështirësitë ekonomike të huamarrësit, i kanë bërë një lëshim huamarrësit që huadhënësi nuk do ta kishte konsideruar në rrethana të tjera;
- Është duke u bërë e mundshme që huamarrësi të falimentojë ose të bëjë një ri-organizim financiar;
- Zhdukja e një tregu aktiv, si rezultat i vështirësive financiare;
- Blerja ose origjinimi i një aktivi financiar me një ulje të madhe që reflekton humbjet e pësuarat të kredisë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Është politika e Bankës që të konsiderojë një instrument financiar si “të përmirësuar” dhe për rrjedhojë ta heqë nga Faza 3, kur asnjë prej kriterëve të klasifikimit si dështim nuk janë prezentë. Vendimi nëse një aktiv i përmirësuar do të klasifikohet nën Fazën 2 apo në Fazën 1, përcaktohet nga kriteret e vendosura në momentin e përmirësimit.

Kriteri i Bankës për qëllimet e HKP-së është më pak i rreptë sesa kërkesa për 24 muajsh e ristrukturimit, që shpjegohet në shënimin 4.o.

Rritja e qenësishme e rrezikut kreditor

Banka në mënyrë të vazhdueshme monitoron të gjithë aktivet e saj të cilat janë subjekt i HKP-së. Me qëllim që të përcaktojë nëse një instrument financiar është subjekt i HKP 12 mujore (Faza 1) apo AGJHKP (Faza 2), Banka vlerëson nëse ka pasur rritje të qenësishme të rrezikut kreditor.

Banka aplikon gjithashtu një metodë të dytë kualitative për të vlerësuar një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë për një aktiv, si lëvizja e një klient/objekti në listën e vëzhgimeve, ose llogaria të bëhet e pavlefshme. Në raste specifike, Banka mund të konsiderojë gjithashtu dhe ngjarje të shpjeguara në shënimin 12 që janë një rritje e rëndësishme në rrezikun e kredisë në krahasim me një mospagim. Për më tepër, nëse pagesat kontraktuale kanë më shumë se 30 ditë vonesë, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur në mënyrë të ndjeshme që nga njohja fillestare.

Kur vlerësohen HKP-të në baza kolektive për grupe aktivesh të ngjashme (si në shënimin 9), Banka aplikon të njëjtat principe për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë.

Ekspozimi në dështim

Ekspozimi në dështim (EAD) përfaqëson vlerën bruto të instrumenteve financiare të cilat janë subjekt i përlllogaritjes së zhvlerësimit, duke adresuar si aftësinë e klientit që të rrisë ekspozimin e tij ndërkohë që mund të dështojë, ashtu edhe ripagesat potenciale para afatit. EAD për kartat e kreditit dhe të tjera ekspozime janë në shënimin 12.

Për të llogaritur EAD-në për një kredi në Fazën 1, Banka vlerëson ngjarjet për mos pagesat e mundshme brenda 12 muajve për llogaritjen e 12mHKP. Për aktivet financiare në Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, ekspozimi në dështim konsiderohet për ngjarje gjatë gjithë jetës së instrumentit.

Banka përcakton EAD-të duke modeluar gamën e rezultateve të mundshme të ekspozimit në pika të ndryshme të kohës, që i korrespondojnë skenarëve të shumfishtë. EAD më pas përcaktohet për çdo skenar ekonomik bazuar në rezultatet e modeleve të Bankës.

Humbja në dështim

Humbja në dështim përfaqëson humbjen e përlllogaritur për ngjarjet e dështimit në një periudhë kohe. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësuar, nëse objekti nuk është çregjistruar më parë dhe është akoma në portofol.

Me qëllim vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit (Faza 1 dhe Faza 2), huatë grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë që janë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve të kontratës (për shembull, mbi bazën e një procesi vlerësimi të kredisë ose gradimi që merr në konsideratë llojin e pasurisë, llojin e klientit, llojin e kolateralit, statusin e borxhit me vonesë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Karakteristikat e zgjedhura janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të këtyre huave, duke qenë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve kontraktuale të aktiveve që po vlerësohen.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Metodologjia konsiston në:

- a) Krijimin e një grupimi për ekspozimet me karakteristika kreditore të ngjashme (p.sh. produktet)
- b) Llogaritje e një PD-je 12 mujore për çdo faze
- c) Llogaritja dhe përafërsim i PD-ve për gjithë jetën për çdo segment me përfshirjen e rregullimit Makro.

Humbja në dështim

Llogaritja e LGD ka përbërësit e mëposhtëm:

- a) Probabiliteti i rikuperimit (Koeficienti i Rikuperimit)
- b) Norma e Humbjes pa Rikuperim

Ngjarjet e rikuperimit janë ekspozime që dalin nga statusi i dështimit (shprehin mundësinë e daljes nga statusi në Fazën 3). Pra ekspozimet që janë në transit nga statusi NPE ose FNPE në PE ose FPE në 12 muaj nga periudha e observimit identifikohen si të rikthyera në statusin e performuesve dhe një ngjarje rikuperimi ka ndodhur. Ekspozimet konsiderohen se kanë ndaluar së qeni jo-performuese kur të gjitha kushtet në vijim plotësohen:

- a) Debitori nuk ka shuma me ditë vonesa më të mëdha se 90 ditë
- b) Një vit ka kaluar që kur masat ristrukturuese u zgjatën
- c) Situata e debitorit është përmirësuar deri në ripagim të plotë, sipas origjinalit ose kur është e aplikueshme prej kushteve të modifikuara, do të bëhen;

Norma e Humbjes përfshin vlerësimin e koeficienteve të rikuperimit për çdo segment duke vëzhguar rikuperimet kumulative historike si përqindje e shumës së mbetur. Përsa i përket rikuperimeve, pagesat monetare historike nga ekspozimet e dështuara merren në konsideratë.

Analiza e përqendrimit të rrezikut

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë për sektor. Një analizë e rrezikut të kredisë në datën e raportimi paraqitet më poshtë:

|                                      | Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto |                   |
|--------------------------------------|-----------------------------------------|-------------------|
|                                      | 31 dhjetor 2024                         | 31 dhjetor 2023   |
| <b>Përqendrimi sipas sektorëve</b>   |                                         |                   |
| Shërbimet                            | 350,248                                 | 359,502           |
| Shitja me shumicë                    | 4,393,903                               | 4,330,509         |
| Ndërtimi                             | 10,728,825                              | 8,506,494         |
| Prodhimi                             | 4,184,617                               | 4,120,464         |
| Pasuritë e patundshme                | 2,172,487                               | 2,197,700         |
| Hotele dhe restorante                | 11,383,991                              | 9,163,807         |
| Energji elektrike, ujë dhe karburant | 3,724,591                               | 3,580,550         |
| Tregti me pakicë                     | 1,512,999                               | 1,500,389         |
| Agrikulture dhe peshkim              | 6,999,694                               | -                 |
| Transportim dhe magazinim            | 2,034,821                               | -                 |
| Të tjera                             | 3,039,734                               | 3,924,562         |
| <b>Biznese</b>                       | <b>50,525,909</b>                       | <b>37,683,977</b> |
| Kredi hipotekore                     | 6,719,988                               | 8,300,732         |
| Kredi konsumatore                    | 1,579,861                               | 469,730           |
| <b>Individë</b>                      | <b>8,299,850</b>                        | <b>8,770,462</b>  |
| <b>Vlera kontabël</b>                | <b>58,825,758</b>                       | <b>46,454,439</b> |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e përqendrimit të rrezikut(vazhdim)

| Shënime                     | Hua dhe paradhënie bankave |                  |
|-----------------------------|----------------------------|------------------|
|                             | 31 dhjetor 2024            | 31 dhjetor 2023  |
| Përqendrimi sipas sektorëve |                            |                  |
| Banka                       | 10,218,525                 | 7,534,218        |
| <b>Vlera kontabël</b>       | <b>10,218,525</b>          | <b>7,534,218</b> |

| Shënime                              | Investime Financiare |                   |
|--------------------------------------|----------------------|-------------------|
|                                      | 31 dhjetor 2024      | 31 dhjetor 2023   |
| Përqendrimi sipas sektorëve          |                      |                   |
| Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare | 57,055,654           | 57,704,430        |
| <b>Vlera kontabël</b>                | <b>57,055,654</b>    | <b>57,704,430</b> |

Cilësia e kredisë së ekspozimit maksimal të kredisë së letrave me vlerë të borxhit bazuar në klasifikimin Moody, kur është e aplikueshme, vijon si më poshtë:

| Shënime           | Investime Financiare<br>(letra me vlerë të borxhit) |                   |
|-------------------|-----------------------------------------------------|-------------------|
|                   | 31 dhjetor 2024                                     | 31 dhjetor 2023   |
| Qeveria Shqiptare |                                                     |                   |
| Klasifikimi B1    | 57,055,654                                          | 57,704,430        |
|                   | <b>57,055,654</b>                                   | <b>57,704,430</b> |

Portofoli i rrezikut të kredisë së Bankës karakterizohet nga përqendrimet e mëposhtme të rrezikut të kredisë.

|                                                             | 31 dhjetor 2024   | Ekspozimi në % | 31 dhjetor 2023   | Ekspozimi në % |
|-------------------------------------------------------------|-------------------|----------------|-------------------|----------------|
| Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë                 | 57,055,654        | 43%            | 57,704,430        | 47%            |
| Gjendjet me Bankën e Shqipërisë                             | 9,356,573         | 7%             | 11,392,619        | 9%             |
| <b>Rreziku total me Qeverinë Shqiptare</b>                  | <b>66,412,227</b> | <b>50%</b>     | <b>69,097,049</b> | <b>56%</b>     |
| Ekspozimi më i madh me Bankat                               | 263,541           | 0%             | 266,164           | 0%             |
| Ekspozimi më i madh me klientët                             | 4,592,613         | 3%             | 2,299,205         | 2%             |
| <b>Totali i ekspozimeve të mëdha me bankat dhe klientët</b> | <b>4,856,154</b>  | <b>3%</b>      | <b>2,565,369</b>  | <b>2%</b>      |
| <b>Totali i rrezikut për zërat e bilancit</b>               | <b>71,268,381</b> | <b>53%</b>     | <b>71,662,418</b> | <b>58%</b>     |

Kundërpartia për ekspozimin më të madh me bankat më 31 dhjetor 2024 është me një Bankë e huaj, Raiffeisen Bank AG (2023: Raiffeisen Bank AG). Kundërpartia për ekspozimin më të madh me klientët në 31 dhjetor 2024 është Shoqeria Koncesionare G2 Infra shpk (2023: OSHEE SHA).

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

|                                                                                       | Ekspozimi Maksimal Bruto |                    |
|---------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|--------------------|
|                                                                                       | 31 dhjetor 2024          | 31 dhjetor 2023    |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre<br>(me përjashtim të mjeteve monetare në arkë) | 5,845,782                | 5,634,775          |
| Hua dhe paradhënie bankave                                                            | 6,864,658                | 6,693,001          |
| Investime financiare – VDATGJ                                                         | 24,181,542               | 25,830,204         |
| Investime financiare me kosto të amortizuar                                           | 36,883,810               | 38,802,286         |
| Hua dhe paradhënie dhënë klientëve                                                    | 58,825,758               | 46,454,439         |
| Qira financiare                                                                       | 331,292                  | 367,766            |
| Debitorë të tjerë                                                                     | (118,619)                | (104,806)          |
| <b>Totali i ekspozimit për zërat e bilancit</b>                                       | <b>132,814,223</b>       | <b>123,677,665</b> |
| Angazhime të pa-tërheqshme ndaj klientëve                                             | 4,397,859                | 3,783,322          |
| Garanci në favor të klientëve                                                         | 1,089,370                | 985,242            |
| Transaksione SPOT                                                                     | 24,519                   | 29,150             |
| <b>Totali i angazhimeve të lidhura me kredinë</b>                                     | <b>5,511,748</b>         | <b>4,797,714</b>   |
| <b>Totali i rrezikut të kredisë</b>                                                   | <b>138,325,971</b>       | <b>128,475,379</b> |

Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në favor të tyre dhe të marr angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për t'ju siguruar likuiditetin e nevojshëm. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten me të njëjtat politika dhe procese kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e lidhura me kredinë për zhvlerësim. Shumat subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlerësim janë angazhime të pa-anulueshme dhënë klientëve të këqij ose klientëve me kredi të ristrukturuara.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela e mëposhtme jep informacion për cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, për aktivet financiare, vlerat e paraqitura në tabelë paraqesin vlerën e mbetur bruto. Për angazhimet kreditore dhe kontratat e garancive financiare, vlerat në tabela paraqesin shumën e angazhimit apo të garantuar. Shpjegimi i termave: Faza 1, Faza 2 dhe Faza 3 përfshihen në Shënimin 11.

| Shënime                                    | Më 31 dhjetor 2024 |                   |                |                | Më 31 dhjetor 2023 |
|--------------------------------------------|--------------------|-------------------|----------------|----------------|--------------------|
|                                            | Faza 1             | Faza 2            | Faza 3         | POCI           | Totali             |
| <b>Arka dhe llogari me Bankën Qendrore</b> |                    |                   |                |                |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                   | 11,351,471         | -                 | -              | -              | 11,351,471         |
| Pakësuar me zhvlerësimin                   | -                  | -                 | -              | -              | -                  |
| <b>Vlera e mbartur</b>                     | <b>9,10</b>        | <b>11,351,471</b> | <b>-</b>       | <b>-</b>       | <b>11,351,471</b>  |
| <b>Hua dhe paradhënie bankave</b>          |                    |                   |                |                |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                   | 3,353,867          | -                 | -              | -              | 3,353,867          |
| Pakësuar me zhvlerësimin                   | -                  | -                 | -              | -              | -                  |
| <b>Vlera e mbartur</b>                     | <b>9,10</b>        | <b>3,353,867</b>  | <b>-</b>       | <b>-</b>       | <b>3,353,867</b>   |
| <b>Letra me vlerë</b>                      |                    |                   |                |                |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                   | 61,097,754         | -                 | -              | -              | 61,097,754         |
| Në ndjekje                                 | -                  | -                 | -              | -              | -                  |
| Pakësuar me zhvlerësimin                   | (32,402)           | -                 | -              | -              | (32,402)           |
| <b>Vlera e mbartur</b>                     | <b>11</b>          | <b>61,065,352</b> | <b>-</b>       | <b>-</b>       | <b>61,065,352</b>  |
| <b>Hua dhe paradhënie dhënë klientëve</b>  |                    |                   |                |                |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                   | 58,020,967         | 116,751           | -              | -              | 58,137,718         |
| Në ndjekje                                 | 2,382              | 525,196           | 4,827          | -              | 532,405            |
| Nënstandarte                               | 68,643             | 77,310            | 375,939        | -              | 521,891            |
| I dyshimtë                                 | 15,066             | 24,544            | 178,376        | -              | 217,986            |
| I humbur                                   | 140,788            | 15,901            | 79,627         | -              | 236,315            |
| Pakësuar me zhvlerësimin                   | (596,805)          | (23,068)          | (200,685)      | -              | (820,558)          |
| <b>Vlera e mbartur</b>                     | <b>12</b>          | <b>57,651,041</b> | <b>736,634</b> | <b>438,083</b> | <b>58,825,758</b>  |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

|                                                    | Më 31 dhjetor 2024 |                |               |          | Më 31 dhjetor 2023 |
|----------------------------------------------------|--------------------|----------------|---------------|----------|--------------------|
|                                                    | Faza 1             | Faza 2         | Faza 3        | POCI     | Total              |
| <b>Qira financiare</b>                             |                    |                |               |          |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                           | 193,722            | -              | -             | -        | 193,722            |
| Nënstandarte                                       | -                  | 110,141        | -             | -        | 110,141            |
| I dyshimtë                                         | -                  | 7,120          | -             | -        | 7,120              |
| Të humbura                                         | -                  | -              | 26,027        | -        | 26,027             |
| Pakësuar me zhvlerësimin                           | (1,940)            | (1,175)        | (2,603)       | -        | (5,717)            |
| <b>Vlera e mbartur</b>                             | <b>191,782</b>     | <b>116,086</b> | <b>23,424</b> | <b>0</b> | <b>331,292</b>     |
|                                                    |                    |                |               |          |                    |
| <b>Garancitë dhe angazhimet e tjera financiare</b> |                    |                |               |          |                    |
| Rrezik i ulët – i drejtë                           | 1,089,370          | -              | -             | -        | 1,089,370          |
| Pakësuar me zhvlerësimin                           | (11,644)           | -              | -             | -        | (11,644)           |
| <b>Vlera e mbartur</b>                             | <b>1,077,727</b>   |                |               |          | <b>975,042</b>     |

Një analizë vjetërsie e kredive në vonesë por jo të zhvlerësuara më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

|                                           | Më 31 dhjetor 2024 |                  |                |                |                      |
|-------------------------------------------|--------------------|------------------|----------------|----------------|----------------------|
|                                           | Më pak se 30 ditë  | 31 në 60 ditë    | 61 në 90 ditë  | 91 në 180 ditë | më shumë se 180 ditë |
| <b>31 dhjetor 2024</b>                    |                    |                  |                |                |                      |
| <b>Hua dhe paradhënie dhënë klientëve</b> |                    |                  |                |                |                      |
| Hua tregtare                              | 49,349,083         | 1,291,444        | 471,796        | 32,293         | 75,801               |
| Hua hipotekore                            | 6,900,874          | 159,492          | 50,050         | 49,502         | 38,088               |
| Hua konsumatore                           | 1,201,874          | 12,361           | 8,983          | 1,051          | 3,623                |
| <b>Qira Financiare</b>                    | 196,091            | -                | 4,750          | 26,027         | 110,141              |
| <b>Totali bruto</b>                       | <b>57,647,923</b>  | <b>1,463,297</b> | <b>535,579</b> | <b>108,873</b> | <b>227,653</b>       |
| Total HKP                                 | 768,844            | 19,836           | 6,438          | 12,860         | 18,296               |
| <b>Neto</b>                               | <b>56,879,078</b>  | <b>1,443,461</b> | <b>529,141</b> | <b>96,013</b>  | <b>209,357</b>       |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

| 31 dhjetor 2023                    | 31 dhjetor 2023   |                  |                |                |                      | Totali            |
|------------------------------------|-------------------|------------------|----------------|----------------|----------------------|-------------------|
|                                    | Më pak se 30 ditë | 31 në 60 ditë    | 61 në 90 ditë  | 91 në 180 ditë | më shumë se 180 ditë |                   |
| Hua dhe paradhënie dhënë klientëve |                   |                  |                |                |                      |                   |
| Hua tregtare                       | 35,887,571        | 1,900,755        | 215,400        | 60,664         | 48,218               | 38,112,608        |
| Hua hipotekore                     | 7,399,294         | 187,545          | 58,447         | 71,963         | 62,657               | 7,779,906         |
| Hua konsumatore                    | 1,102,763         | 10,389           | 10,201         | 3,723          | 2,466                | 1,129,542         |
| Qira Financiare                    | 344,935           | -                | -              | -              | 29,723               | 374,658           |
| <b>Totali bruto</b>                | <b>44,734,563</b> | <b>2,098,689</b> | <b>284,048</b> | <b>136,350</b> | <b>143,064</b>       | <b>47,396,714</b> |
| Total HKP                          | 469,509           | 28,240           | 4,439          | 12,582         | 59,739               | 574,509           |
| <b>Neto</b>                        | <b>44,265,054</b> | <b>2,070,449</b> | <b>279,609</b> | <b>123,768</b> | <b>83,325</b>        | <b>46,822,205</b> |

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara

Huatë e zhvlerësuara janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjendje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) së huasë. Banka i klasifikon huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme siç përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huatë që shfaqin evidence objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar fluksin e skontuar monetar të ardhshëm dhe duke e krahasuar me vlerën kontabël të mbetur respektive të huasë. Huatë, të cilat nuk paraqesin evidenca për t'u zhvlerësuar individualisht, vlerësohen për zhvlerësim në grup. Zhvlerësimi në grup aplikohet gjithashtu edhe për klientë të testuar individualisht por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon huatë dhe paradhëniet neto ndaj klientëve të klasifikuara në dy grupe kryesore, të zhvlerësuara individualisht dhe në grup.

|                                                                       | Ekspozimi Neto i huave dhe paradhënieve ndaj klientëve |                   |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|-------------------|
|                                                                       | 31 dhjetor 2024                                        | 31 dhjetor 2023   |
| individualisht të zhvlerësuara                                        |                                                        |                   |
| Balanca bruto                                                         | 638,768                                                | 192,408           |
| Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi                                   | (200,685)                                              | (69,209)          |
| <b>Vlera kontabël</b>                                                 | <b>438,083</b>                                         | <b>123,199</b>    |
| Të zhvlerësuara në grup                                               |                                                        |                   |
| Balanca bruto                                                         | 59,007,548                                             | 46,829,679        |
| Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi                                   | (619,872)                                              | (498,439)         |
| <b>Vlera kontabël</b>                                                 | <b>58,387,675</b>                                      | <b>46,331,240</b> |
| <b>Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhënieve për klientët</b> | <b>58,825,758</b>                                      | <b>46,454,439</b> |

Lëvizjet e veçanta për zhvlerësimet individuale dhe në grup paraqiten të detajuara në shënimin 12.

Tabela më poshtë tregon **qiratë financiare neto** të kategorizuara brenda dy grupeve kryesore: të zhvlerësuara individualisht dhe në grup.

|                                                                       | Ekspozimi neto për qira financiare |                 |
|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------|
|                                                                       | 31 dhjetor 2024                    | 31 dhjetor 2023 |
| individualisht të zhvlerësuara                                        |                                    |                 |
| Balanca bruto                                                         | 25,795.63                          | 34,930          |
| Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi                                   | (2,602.66)                         | (3,493)         |
| <b>Vlera kontabël</b>                                                 | <b>23,192.97</b>                   | <b>31,437</b>   |
| Të zhvlerësuara në grup                                               |                                    |                 |
| Balanca bruto                                                         | 311,213.95                         | 339,726         |
| Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi                                   | (3,114.79)                         | (3,397)         |
| <b>Vlera kontabël</b>                                                 | <b>308,099</b>                     | <b>336,329</b>  |
| <b>Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhënieve për klientët</b> | <b>331,292</b>                     | <b>367,766</b>  |

Lëvizjet për zhvlerësimin e qirasë financiare janë detajuar në shënimin 14.

Më poshtë është një analizë e balancave bruto dhe neto (nga zbritja për humbjet nga zhvlerësimi) për huatë e zhvlerësuara individualisht sipas klasifikimit të rrezikut:

|                          | Hua dhe paradhënie klientëve të zhvlerësuar individualisht |                |                 |                |
|--------------------------|------------------------------------------------------------|----------------|-----------------|----------------|
|                          | 31 dhjetor 2024                                            |                | 31 dhjetor 2023 |                |
|                          | Bruto                                                      | Neto           | Bruto           | Neto           |
| <b>31 dhjetor 2024</b>   |                                                            |                |                 |                |
| Rrezik i ulët – i drejtë | -                                                          | -              | -               | -              |
| Në ndjekje               | 4,596                                                      | 4,115          | 372             | 17             |
| Nënstandarte             | 375,939                                                    | 229,880        | 52,608          | 45,423         |
| I dyshimtë               | 178,376                                                    | 151,119        | 70,320          | 59,673         |
| I humbur                 | 105,653                                                    | 76,161         | 104,039         | 49,524         |
| <b>Totali</b>            | <b>664,564</b>                                             | <b>461,276</b> | <b>227,339</b>  | <b>154,637</b> |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat e saj një gjendje huaje/letre me vlerë (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provigjonimit (SAC) përcakton se huaja/letra me vlerë është e pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacioneve për ndryshime të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimet, dhe përfitimet nga kolateralet nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për kreditë e standardizuara me vlerë më të vogël, vendimet për fshirjen, bazohen në statusin specifik të vonesave në pagesa të produktit si edhe në veprimet ligjore të ndjekura lidhur me procedurën e zbatimit.

Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë. Banka zotëron kolaterale kryesisht në formën e:

- Hipotekave të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose të biznesit;
- Pengjeve mbi aktivet e biznesit në funksionim, të tilla si makineri dhe pajisje, inventarë dhe llogari të arkëtueshme;
- Mjete monetare të lëna garanci dhe letra me vlerë (si Bono Thesari), etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore.

Flukset e parashikuara të të ardhurave nga kolateralet, përfshirë garancitë që mbulojnë ekspozimet, janë zakonisht burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- Vlera e realizueshme e kolateraleve**, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve me një ‘faktor skontimi’. Kjo merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve dhe supozon një vlerë mesatare të rikuperueshme të një kolateralit të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës.
- Koha e flukseve të parashikuara/pritura të parasë**, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolateralit.

Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të riblerjeve dhe aktivitetit të huamarrjes të letrave me vlerë.

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve, kolateralet që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasuritë e paluajtshme, mjetet monetare të vendosura si kolateral dhe garancitë bankare.

Nuk ka kolaterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç rasteve të marrëveshjeve të riblerjes të anasjellta. Për pjesën më të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumën e kredive, megjithatë, Banka normalisht e skonton vlerën e drejtë të kolateralit me të paktën 49% në mënyrë që të mbajë parasysh vështirësitë praktike dhe administrative të ekzekutimit të një kolateralit. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mos pagesat e mundshme nga klienti.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuar

Më poshtë jepet detajimi i vlerës së mbartur të kredive dhe paradhënieve të zhvlerësuar individualisht (duke përfshirë ekspozime jashtë bilancit) sipas kategorive, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit të marrë nga Banka për të siguruar këto kredi:

|                               | 31 dhjetor 2024    |                                  | 31 dhjetor 2023    |                                  |
|-------------------------------|--------------------|----------------------------------|--------------------|----------------------------------|
|                               | Hua të zhvlerësuar | Kolaterali me marzhet reduktuese | Hua të zhvlerësuar | Kolaterali me marzhet reduktuese |
| Korporatë+SME                 | 424,302            | 302,684                          | 40,807             | 38,717                           |
| SBE                           | 84,609             | 139,705                          | 13,239             | 55,885                           |
| Të siguruara individualisht   | 127,004            | 297,460                          | 135,615            | 292,087                          |
| Të pasiguruara individualisht | 2,621              | -                                | 2,745              | -                                |
| Qira financiare               | 26,027             | 13,117                           | 34,932             | -                                |
| Garanci                       | -                  | -                                | -                  | -                                |
| <b>Totali bruto</b>           | <b>664,564</b>     | <b>752,966</b>                   | <b>227,338</b>     | <b>386,689</b>                   |
| Total HKP                     | (203,288)          | -                                | (72,702)           | -                                |
| <b>Neto</b>                   | <b>461,276</b>     | <b>-</b>                         | <b>154,636</b>     | <b>-</b>                         |

Kur Banka mban prona të marra në zotërim nën emrin e tyre, konvertimi i tyre në para është qëllimi parësor i Bankës, nëpërmjet marketing të pronave në shitje. Të ardhurat përdoren për të zvogëluar ose likuiduar vlerën kontabël të huave. Nëse nuk ka oferta të kënaqshme, Banka e ka si praktikë të mbajë aktive të vlefshme për shitje derisa të marrë një ofertë më të mirë. Në varësi të nevojave operationale dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i përmbushur ato kushte, menaxhimi mund të vendosë të përdor pronën; në këto raste bëhet një riklasifikim i pronës në aktive afatgjata materiale të Bankës. Balancat respektive të aktiveve të marra në zotërim janë dhënë në shënimin 17.

Struktura e kolateraleve të huave në Faza të ndryshme janë si më poshtë:

| 31 dhjetor 2024             | Faza 1            | Faza 2           | Faza 3         | POCI     | Totali            |
|-----------------------------|-------------------|------------------|----------------|----------|-------------------|
| Pronë me marzh të reduktuar | 53,161,405        | 1,218,292        | 733,061        | -        | 55,112,759        |
| Pengje                      | -                 | -                | -              | -        | -                 |
| Mjete monetare              | 4,496,509         | 6,110            | 19,904         | -        | 4,522,524         |
| <b>Totali</b>               | <b>57,657,914</b> | <b>1,224,402</b> | <b>752,966</b> | <b>-</b> | <b>59,635,282</b> |

| 31 dhjetor 2023             | Faza 1            | Faza 2           | Faza 3         | POCI     | Totali            |
|-----------------------------|-------------------|------------------|----------------|----------|-------------------|
| Pronë me marzh të reduktuar | 41,432,523        | 1,164,725        | 386,488        | -        | 42,983,736        |
| Pengje                      | -                 | -                | -              | -        | -                 |
| Mjete monetare              | 3,124,800         | 7,593            | 201            | -        | 3,132,595         |
| <b>Totali</b>               | <b>44,557,323</b> | <b>1,172,318</b> | <b>386,689</b> | <b>-</b> | <b>46,116,331</b> |

Hua dhe paradhënie të ri-negociuara

Aktivitetet e ristrukturuara përfshijnë marrëveshje pagesë të zgjatura, modifikime dhe shtyrje të pagesave. Në vijim të ristrukturimit, pas shlyerjes së pagesave në vonesë, llogaria e një klienti me vonesa rivendoset në statusin normal dhe menaxhohet së bashku me llogari të tjera të ngjashme. Totali i portofolit të ristrukturimeve gjatë vitit 2024 është 0.8 milion Lekë (2023: 0.9 milion lekë).

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Në rrethanat aktuale ekonomike, Banka është inkurajuar, rekomanduar dhe kërkuar nga qeveria dhe rregullatorët për të ofruar hua të reja për klientët nën 2-lloje të Huasë Sovrane të qeverisë.

Karakteristikat kryesore të secilit program mbështetës përfshijnë (por jo duke u kufizuar) sa më poshtë:

1- Pagesa e pagave të pranueshme brenda programit Covid-19

- Kreditë mbështeten 100% nga garancitë qeveritare në një total prej 300,000,000 ALL;
- Fondet janë disbursuar vetëm për të mbështetur pagat deri në tre muaj rresht (të llogaritura bazuar në listë pagesën e Shkurtit);
- Norma e interesit të aplikueshme llogaritet si rendiment i 12M Bono thesari e rregulluar për një premium 0.5%, deri në 2.85%;
- Huadhënësit duhet të klasifikohen zyrtarisht si klientë / industri / sektorë të prekur nga pandemia;
- Këto hua do të disbursohen me një tarifë administrimi prej 0% dhe do të aplikohet një periudhë faljeje prej 3 muajsh; dhe
- Kreditë e disbursuara vetëm në ALL, kanë një maturim deri në 2 vjet.
- Nuk ka hua të pashlyera që bëjnë pjesë në programin GS1 në fund te vitit.

2- Huatë Sovrane në kuadër të programit Covid-19, për zhvillimin e biznesit ("Kapital Qarkullues")

- Kreditë mbështeten 60% nga garancitë qeveritare në një total prej 400.000.000 ALL;
- Kreditë do të lehtësojnë huadhënësin për adresimin e kapitalit qarkullues dhe nevojat e investimeve dhe për të siguruar mbështetje për operationet tregtare. Në asnjë rrethanë, fondet nuk duhet të përdoren për të financuar veprimtari të paligjshme ose për të refinancuar kredie të tjera.
- Norma e interesit e zbatueshme llogaritet si rendiment i 12M Bono thesari e rregulluar për një premium 3.00%, deri në 5.00%;
- Huadhënësit duhet të klasifikohen zyrtarisht si industri / sektorë të prekur dhe të mbyllur përkohësisht nga pandemia;
- Këto hua duhet do të disbursohen me një tarifë administrimi prej 0% dhe të aplikojnë një periudhë faljeje deri në 6 muaj; dhe
- Kreditë e disbursuara vetëm në ALL, kanë një maturim deri në 5 vjet.

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë. Rrezik i shlyerjes me institucione financiare dhe kundërpartinë tjetër qeveritare përfshihet brenda një sistemi limitesh për të gjitha transaksionet me këto kundërparti dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, përcaktuar dhe rregulluar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankës".

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si paafësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (rrezik i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Përqasja e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, të ketë gjithnjë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e saj.

Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:

- Financim të përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përmbushjen e kërkesave. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;
- Mbajtjen e një portofoli aktivesh likuide dhe të arkëtueshme;
- Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullatore; dhe
- Menaxhimi i përqendrimit dhe profilizimit të borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet nën monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet funksioneve të ndryshme të Bankës mbulojnë flukset monetare të vlerësuara për ditën, javën, dhe muajin pasues që konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pikënisja e projekteve është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtra dhe afatmesme është nën përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon në baza mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

Elementi kyç i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra dhe hendeku kumulativ deri në 3 muaj. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to si dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja “Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Banka përlogarit mbi baza javore dhe mujore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave. Aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurtër me bankat të cilat maturohen brenda 7 ditëve.

Detaje të raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese ka qenë si më poshtë:

|                         | 31 dhjetor 2024 | 31 dhjetor 2023 |
|-------------------------|-----------------|-----------------|
| Mesatarja për periudhën | 62.20%          | 62.42%          |
| Minimumi për periudhën  | 52.22%          | 51.52%          |
| Maksimumi për periudhën | 72.84%          | 79.40%          |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela në vijim tregon gjendjen e likuiditetit të Bankës monitoruar aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 dhjetor 2024. Janë marrë në konsideratë flukset monetare të paskontuara hyrëse/dalëse të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare të bilancit dhe jashtë bilancit, sipas maturiteteve kontraktuale dhe duke mos reflektuar ndonjë ri pagesa të hershme apo supozime për historikun e mbajtjes. Nëse maturimi kontraktual nuk është i aplikueshëm, Banka ka përdorur gjykimin në vlerësimin e periudhës kur këto aktive dhe detyrime financiare do të maturohen.

| 31 dhjetor 2024                                         | 1 muaj                        | 1-3 muaj                      | 3-12 muaj                     | 1-5vite                       | Mbi 5vjet                   | Totali                       |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <strong>AKTIVE</strong>                                 |                               |                               |                               |                               |                             |                              |
| Mjete monetare, neto                                    | 7,840,680                     |                               |                               |                               |                             | 7,840,680                    |
| Rezerva e detyrueshme                                   | 1,964,145                     | 343,430                       | 1,545,437                     | 3,011,646                     | -                           | 6,864,658                    |
| Paradhënie bankave                                      | -                             |                               |                               |                               |                             | -                            |
| Investime në letra me vlerë                             | 7,086,716                     | 4,654,102                     | 3,282,040                     | 32,246,071                    | 13,796,422                  | 61,065,352                   |
| Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)    | 2,558,828                     | 8,681,485                     | 12,489,041                    | 23,124,345                    | 11,972,060                  | 58,825,758                   |
| Qira Financiare                                         | 22,151                        | 8,923                         | 37,226                        | 205,672                       | 57,319                      | 331,292                      |
| Aktive financiare të tjera                              | 31,102                        | (96,094)                      | 60,454                        | 3,252,641                     | -                           | 3,248,103                    |
| <strong>TOTALI</strong>                                 | <strong>19,503,622</strong>   | <strong>13,591,847</strong>   | <strong>17,414,197</strong>   | <strong>61,840,376</strong>   | <strong>25,825,801</strong> | <strong>138,175,844</strong> |
| <strong>DETYRIME</strong>                               |                               |                               |                               |                               |                             |                              |
| Llogari rrjedhëse me bankat                             | -                             |                               |                               |                               |                             | -                            |
| Llogari rrjedhëse/kursimi me klientët                   | 8,021,848                     | 1,250,692                     | 5,628,112                     | 16,165,221                    | 2,835,712                   | 33,901,584                   |
| Depozita nga bankat                                     | 22,401,235                    | -                             | -                             | -                             | -                           | 22,401,235                   |
| Depozita me afat nga klientët                           | 4,731,756                     | 5,697,644                     | 27,145,568                    | 28,834,437                    | 199,438                     | 66,608,842                   |
| Borxhi i varur                                          | 23,029                        | -                             | -                             | -                             | 1,683,945                   | 1,706,974                    |
| Detyrime financiare të tjera                            | 344,665                       | 190,002                       | 1,756,577                     | 94,203                        | 98,373                      | 2,483,820                    |
| <strong>TOTALI</strong>                                 | <strong>35,522,532</strong>   | <strong>7,138,337</strong>    | <strong>34,530,257</strong>   | <strong>45,093,861</strong>   | <strong>4,817,468</strong>  | <strong>127,102,455</strong> |
| <strong>HENDEKU TOTAL I ZËRAVE TË BILANCIT</strong>     | <strong>(16,018,910)</strong> | <strong>6,453,510</strong>    | <strong>(17,116,059)</strong> | <strong>16,746,515</strong>   | <strong>21,008,333</strong> | <strong>11,073,388</strong>  |
| Zëra jashtë bilanci (flukse monetare hyrëse)            | -                             | -                             | -                             | -                             | -                           | -                            |
| Zëra jashtë bilanci (flukse monetare dalëse)            | 69,055                        | 2,916,446                     | 1,149,653                     | 208,081                       | 54,624                      | 4,397,859                    |
| <strong>HENDEKU TOTAL I ZËRAVE JASHTË BILANCIT</strong> | <strong>(69,055)</strong>     | <strong>(2,916,446)</strong>  | <strong>(1,149,653)</strong>  | <strong>(208,081)</strong>    | <strong>(54,624)</strong>   | <strong>(4,397,859)</strong> |
| <strong>HENDEKU TOTAL 31 dhjetor 2024</strong>          | <strong>(16,087,965)</strong> | <strong>3,537,064</strong>    | <strong>(18,265,712)</strong> | <strong>16,538,434</strong>   | <strong>20,953,709</strong> | <strong>6,675,530</strong>   |
| <strong>HENDEKU I AKUMULUAR 31 dhjetor 2024</strong>    | <strong>(16,087,965)</strong> | <strong>(12,550,902)</strong> | <strong>(30,816,614)</strong> | <strong>(14,278,180)</strong> | <strong>6,675,530</strong>  | <strong>-</strong>           |

Si pjesë e administrimit të rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide që përfshijnë mjete monetare dhe të ngjashme me to dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria, të cilat mund të shiten lehtësisht për të përmbushur nevojat për likuiditet. Flukset monetare të pritshme të Bankës për disa detyrime financiare variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga flukset monetare kontraktuale si për shembull llogaritë rrjedhëse të klientëve të cilat piten të jenë të qëndrueshme dhe nuk priten të tërhiqen.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela në vijim tregon gjendjen e likuiditetit të Bankës monitoruar aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 dhjetor 2023.

| 31 dhjetor 2023                                         | 1 muaj                        | 1-3 muaj                      | 3-12 muaj                     | 1-5vite                      | Mbi 5vjet                   | Totali                       |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <strong>AKTIVE</strong>                                 |                               |                               |                               |                              |                             |                              |
| Mjete monetare, neto                                    | 7,181,833                     | -                             | -                             | -                            | -                           | 7,181,833                    |
| Rezerva e detyrueshme                                   | 1,937,136                     | 334,269                       | 1,504,210                     | 2,823,446                    | -                           | 6,599,061                    |
| Paradhënie bankave                                      | 93,940                        | -                             | -                             | -                            | -                           | 93,940                       |
| Investime në letra me vlerë                             | 5,003,077                     | 8,801,015                     | 6,037,284                     | 36,856,018                   | 7,935,096                   | 64,632,490                   |
| Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)    | 714,134                       | 1,846,611                     | 11,023,600                    | 21,169,200                   | 11,700,893                  | 46,454,439                   |
| Qira Financiare                                         | 16,893                        | 11,848                        | 55,187                        | 210,298                      | 73,540                      | 367,766                      |
| Aktive financiare të tjera                              | 21,832                        | (112,786)                     | 46,873                        | 3,433,815                    | -                           | 3,389,734                    |
| <strong>TOTALI</strong>                                 | <strong>14,968,845</strong>   | <strong>10,880,957</strong>   | <strong>18,667,154</strong>   | <strong>64,492,777</strong>  | <strong>19,709,529</strong> | <strong>128,719,263</strong> |
| <strong>DETYRIME</strong>                               |                               |                               |                               |                              |                             |                              |
| Llogari rrjedhëse me bankat                             | -                             | -                             | -                             | -                            | -                           | -                            |
| Llogari rrjedhëse/kursimi me klientët                   | 7,749,442                     | 1,176,321                     | 5,293,445                     | 15,194,615                   | 2,978,934                   | 32,392,757                   |
| Depozita nga bankat                                     | 24,994,569                    | 2,548,287                     | -                             | -                            | -                           | 27,542,856                   |
| Depozita me afat nga klientët                           | 4,902,824                     | 4,021,219                     | 20,194,438                    | 25,850,945                   | 314,828                     | 55,284,254                   |
| Borxhi i varur                                          | 23,675                        | -                             | -                             | -                            | 1,742,964                   | 1,766,639                    |
| Detyrime financiare të tjera                            | 306,485                       | 190,878                       | 1,487,673                     | 64,312                       | 37,575                      | 2,086,923                    |
| <strong>TOTALI</strong>                                 | <strong>37,976,995</strong>   | <strong>7,936,705</strong>    | <strong>26,975,556</strong>   | <strong>41,109,872</strong>  | <strong>5,074,301</strong>  | <strong>119,073,429</strong> |
| <strong>HENDEKU TOTAL I ZËRAVE TË BILANCIT</strong>     | <strong>(23,008,150)</strong> | <strong>2,944,252</strong>    | <strong>(8,308,402)</strong>  | <strong>23,382,905</strong>  | <strong>14,635,228</strong> | <strong>9,645,834</strong>   |
| Zëra jashtë bilanci (flukse monetare hyrëse)            | -                             | -                             | -                             | -                            | -                           | -                            |
| Zëra jashtë bilanci (flukse monetare dalëse)            | 32,145                        | 32,040                        | 2,028,261                     | 1,641,930                    | 48,947                      | 3,783,323                    |
| <strong>HENDEKU TOTAL I ZËRAVE JASHTË BILANCIT</strong> | <strong>(32,145)</strong>     | <strong>(32,040)</strong>     | <strong>(2,028,261)</strong>  | <strong>(1,641,930)</strong> | <strong>(48,947)</strong>   | <strong>(3,783,323)</strong> |
|                                                         |                               |                               |                               |                              |                             | -                            |
| <strong>HENDEKU TOTAL 31 dhjetor 2023</strong>          | <strong>(23,040,295)</strong> | <strong>2,912,212</strong>    | <strong>(10,336,663)</strong> | <strong>21,740,975</strong>  | <strong>14,586,281</strong> | <strong>5,862,511</strong>   |
| <strong>HENDEKU I AKUMULUAR 31 dhjetor 2023</strong>    | <strong>(23,040,295)</strong> | <strong>(20,128,083)</strong> | <strong>(30,464,746)</strong> | <strong>(8,723,771)</strong> | <strong>5,862,510</strong>  | <strong>-</strong>           |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Informacioni më poshtë lidhet me fluksin e mjeteve monetare që vjen nga detyrimet financiare jashtë bilancit, kështu që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga prezantimi në pasqyrën e pozicionit financiar. Analiza nuk përfshin detyrimet jo-financiare dhe kapitalin dhe përfshin flukset e mjeteve monetare nga interesi kontraktual.

Tabela më poshtë tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet financiare të Bankës:

|                        | 1 Muaj  | 1-3 Muaj  | 3-12 Muaj | 1-5 Vjet  | >5 Vjet | Totali           |
|------------------------|---------|-----------|-----------|-----------|---------|------------------|
| <b>31 dhjetor 2024</b> |         |           |           |           |         |                  |
| Angazhime              | 69,055  | 2,916,446 | 1,149,653 | 208,081   | 54,624  | <b>4,397,859</b> |
| Garanci                | 160,774 | 58,145    | 466,177   | 365,606   | 38,668  | <b>1,089,370</b> |
| Transaksione SPOT      | 24,519  |           |           |           |         | <b>24,519</b>    |
| <b>31 dhjetor 2023</b> |         |           |           |           |         |                  |
| Angazhime              | 32,145  | 32,040    | 2,028,261 | 1,641,930 | 48,947  | <b>3,783,323</b> |
| Garanci                | 94,206  | 227,624   | 123,112   | 500,257   | 40,043  | <b>985,242</b>   |
| Transaksione SPOT      | 29,150  | -         | -         | -         | -       | <b>29,150</b>    |

Banka pret që vetëm një pjesë e vogël e angazhimeve të kërkohet brenda një muaji dhe garancitë të mbyllen sipas afatit të maturimit. Shikoni gjithashtu shënimin 32 mbi Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara.

Rakordimi ndërmjet tabelës së maturitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara dhe shënitit 32 Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara është si më poshtë:

|                                      | 31 dhjetor 2024  | 31 dhjetor 2023  |
|--------------------------------------|------------------|------------------|
| <b>Angazhime</b>                     | <b>4,397,859</b> | <b>3,783,322</b> |
| Hua të aprovuara por të padisbursuar | 4,397,859        | 3,783,322        |
| <b>Garanci</b>                       | <b>1,089,370</b> | <b>985,242</b>   |
| Letrat e kreditit                    | -                | -                |
| Garancitë në favor të klientit       | 1,089,370        | 985,242          |
| <b>Transaksione SPOT</b>             | <b>24,519</b>    | <b>29,150</b>    |

Flukset monetare të paskontuara për detyrimet financiare të bilancit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 vijnë si më poshtë:

|                         | Vlera kontabël     | Fluksi Monetar Bruto | 1 Muaj     | 1-3 Muaj  | 3-12Muaj   | > 1 vit    |
|-------------------------|--------------------|----------------------|------------|-----------|------------|------------|
| <b>31 dhjetor 2024</b>  |                    |                      |            |           |            |            |
| Detyrime ndaj bankave   | <b>22,401,235</b>  | <b>22,401,235</b>    | 22,401,235 | -         | -          | -          |
| Detyrime ndaj klientëve | <b>100,510,426</b> | <b>100,510,426</b>   | 12,753,604 | 6,948,335 | 32,773,680 | 48,034,807 |
| Borxh i varur           | <b>1,706,974</b>   | <b>1,706,974</b>     | 23,029     | -         | -          | 1,683,945  |
| <b>31 dhjetor 2023</b>  |                    |                      |            |           |            |            |
| Detyrime ndaj bankave   | <b>27,542,856</b>  | <b>27,542,856</b>    | 24,994,569 | 2,548,287 | -          | -          |
| Detyrime ndaj klientëve | <b>87,677,011</b>  | <b>87,677,011</b>    | 12,652,266 | 5,197,540 | 25,487,883 | 44,339,322 |
| Borxh i varur           | <b>1,766,639</b>   | <b>1,766,639</b>     | 23,675     | -         | -          | 1,742,964  |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, nivelet e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/emetuesit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin mbi rrezikun.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Banka e mban portofolin e letrave me vlerë në përputhje me SNRF 9 me Kosto të Amortizuar ose me Vlerë të Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të krijojnë ndryshime të konsiderueshme, pozitive ose negative në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Burimet më të rëndësishme të rrezikut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet në monedhë të huaj dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letra në vlerë;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja.

Bordi i Drejtuesve vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për të dy pozicionet , njëditor dhe brenda ditës, të cilat monitorohen çdo ditë nga specialisti i Divizionit të Riskut Operacional dhe Kontrolleve të përhershme.

Analizat e ndjeshmërisë ndaj kursit të këmbimit përfshijnë skenarë standard të rënies dhe rritjes me 200 pikë bazë (bps) të kursit të këmbimit të valutave kryesore EUR (2024: 1,254 mijë Lekë; 2023: 57,486 mijë Lekë) dhe USD (2024: 5,526 mijë Lekë; 2023: 15,427 mijë Lekë) në fitim ose humbje dhe kapital. Analiza e mëposhtme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në Lekë dhe monedha të huaja. Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në datën e bilancit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

| 31 dhjetor 2024                             | LEKË              | EUR               | USD              | Të tjera        | Totali             |
|---------------------------------------------|-------------------|-------------------|------------------|-----------------|--------------------|
| <b>Aktive</b>                               |                   |                   |                  |                 |                    |
| Mjete monetare dhe të ngjashme              | 1,777,542         | 4,884,112         | 1,028,729        | 150,297         | 7,840,680          |
| Hua dhe paradhënie bankave                  | 2,188,544         | 4,329,034         | 347,080          | -               | 6,864,658          |
| Investime financiare – VDATGJ               | 11,102,592        | 9,971,565         | 3,107,385        | -               | 24,181,542         |
| Investime financiare me kosto të amortizuar | 35,392,157        | 1,749,638         | (211,330)        | (46,655)        | 36,883,810         |
| Hua dhe paradhënie ndaj klientëve           | 24,776,148        | 33,997,950        | 51,513           | 147             | 58,825,758         |
| Qira Financiare                             |                   | 331,292           |                  |                 | 331,292            |
| Aktive financiare të tjera                  | 29,835            | 32,622            | 701              | 138             | 63,296             |
| <b>Totali</b>                               | <b>75,266,818</b> | <b>55,296,213</b> | <b>4,324,078</b> | <b>103,927</b>  | <b>134,991,036</b> |
| <b>Detyrime</b>                             |                   |                   |                  |                 |                    |
| Detyrime ndaj bankave                       | 21,929,338        | 460,585           | 11,312           | -               | 22,401,235         |
| Detyrime ndaj klientëve                     | 43,464,078        | 52,334,981        | 4,561,273        | 150,094         | 100,510,426        |
| Borxhi i varur                              | 684,966           | 1,022,008         | -                | -               | 1,706,974          |
| Detyrimet e qirasë                          | 1,130,398         | -                 | -                | -               | 1,130,398          |
| Detyrime financiare të tjera                | 1,054,797         | 1,417,089         | 11,934           | -               | 2,483,820          |
| <b>Totali</b>                               | <b>68,263,577</b> | <b>55,234,663</b> | <b>4,584,519</b> | <b>150,094</b>  | <b>128,232,853</b> |
| <b>Pozicioni neto</b>                       | <b>7,003,241</b>  | <b>61,550</b>     | <b>(260,441)</b> | <b>(46,167)</b> | <b>6,758,183</b>   |
| <b>31 dhjetor 2023</b>                      |                   |                   |                  |                 |                    |
| <b>Aktive</b>                               |                   |                   |                  |                 |                    |
| Mjete monetare dhe të ngjashme              | 3,638,584         | 1,995,435         | 1,500,226        | 47,589          | 7,181,834          |
| Hua dhe paradhënie bankave                  | 1,999,068         | 4,249,677         | 444,256          | -               | 6,693,001          |
| Investime financiare – VDATGJ               | 9,616,331         | 12,452,507        | 3,804,237        | (42,870)        | 25,830,205         |
| Investime financiare me kosto të amortizuar | 36,915,222        | 1,864,417         | (117,920)        | 140,567         | 38,802,286         |
| Hua dhe paradhënie ndaj klientëve           | 17,466,776        | 28,971,886        | 8,076            | 7,701           | 46,454,439         |
| Qira Financiare                             | -                 | 367,766           | -                |                 | 367,766            |
| Aktive financiare të tjera                  | 4,638             | 17,633            | 689              | (423)           | 22,537             |
| <b>Totali</b>                               | <b>69,640,619</b> | <b>49,919,321</b> | <b>5,639,564</b> | <b>152,564</b>  | <b>125,352,068</b> |
| <b>Detyrime</b>                             |                   |                   |                  |                 |                    |
| Detyrime ndaj bankave                       | 27,166,165        | 366,822           | 9,869            | -               | 27,542,856         |
| Detyrime ndaj klientëve                     | 38,350,157        | 44,363,420        | 4,900,562        | 62,872          | 87,677,011         |
| Borxhi i varur                              | 684,967           | 1,081,672         | -                | -               | 1,766,639          |
| Detyrimet e qirasë                          | 371,353           | -                 | -                | -               | 371,353            |
| Detyrime financiare të tjera                | 960,778           | 1,121,601         | 4,544            | -               | 2,086,923          |
| <b>Totali</b>                               | <b>67,533,420</b> | <b>46,933,515</b> | <b>4,914,975</b> | <b>62,872</b>   | <b>119,444,782</b> |
| <b>Pozicioni neto</b>                       | <b>2,107,199</b>  | <b>2,985,806</b>  | <b>724,589</b>   | <b>89,692</b>   | <b>5,907,286</b>   |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku kryesor i normës së interesit ndaj të cilit janë të ekspozuar portofolet e Bankës është rreziku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të mjeteve ose vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesave të tregut. Rreziku krijohet fillimisht nga portofoli i letrave me vlerë, si edhe aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët. Rreziku i normave të interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit periodik të shpërndarjes të normave të interesit midis aktiveve dhe detyrimeve të Bankës si dhe duke përgatitur skenarë analizash mbi normat e interesit për qëllime vendimmarrjeje.

Skenarët standardë që konsiderohen mbi baza mujore përfshijnë një rënie ose ngritje prej 200 pikë bazë (bps) në të gjitha normat e interesit deri në një vit dhe një rënie ose ngritje prej 200 pikësh bazë (bps) në të gjitha normat e interesit për më shumë se një vit. Analiza e ndjeshmërisë e mëposhtme tregon impaktin në fitimin ose humbjen e Bankës. Nuk ka impakt në balancat e kapitalit, përveç impaktit të drejtpërdrejtë në fitim ose humbje.

| 31 dhjetor 2024                      |               |                      |               |               |
|--------------------------------------|---------------|----------------------|---------------|---------------|
| Skenari<br>Deri në 1 vit             |               | Skenari<br>Mbi 1 vit |               |               |
| 200 pikë bazë                        | 200 pikë bazë | 200 pikë bazë        | 200 pikë bazë | 200 pikë bazë |
| Ngritje                              | Ulje          | Ngritje              | Ulje          | Ulje          |
| Efekti i vlerësuar në Fitim/(Humbje) |               |                      |               |               |
| (163,749)                            | 163,749       | 892,775              | (892,775)     |               |
| <b>31 dhjetor 2023</b>               |               |                      |               |               |
| Skenari<br>Deri në 1 vit             |               | Skenari<br>Mbi 1 vit |               |               |
| 200 pikë bazë                        | 200 pikë bazë | 200 pikë bazë        | 200 pikë bazë | 200 pikë bazë |
| Ngritje                              | Ulje          | Ngritje              | Ulje          | Ulje          |
| Efekti i vlerësuar në Fitim/(Humbje) |               |                      |               |               |
| (125,184)                            | 125,184       | 937,608              | (937,608)     |               |

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit (vazhdim)

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Në tabelë janë të përfshira si aktivet dhe detyrimet financiare me norma interesi të pandryshueshme ashtu edhe ato me norma interesi të ndryshueshme.

| 31 dhjetor 2024                                               | Deri në 1 muaj      | 1 deri në 3 muaj  | 3 deri në 12 muaj   | Mbi 1 vit         | Pa interes       | Totali             |
|---------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------|---------------------|-------------------|------------------|--------------------|
